

120-vjetori i lindjes së
Etëhem Haxhiademit

PËRDORIMI I MITEVE KLASIKE NË TRAGJEDITË E HAXHIADEMIT

Nga Migena Kapllani

(fq. 8)



IN MEMORIAM: ABDULATIF ARNAUTI

PROMOVUESI MË I MADH
I LETËRSISË SHQIPE NË
BOTËN ARABE

Nga Muhamed Mufaku (fq. 6)

ABDUL LATIF ARNAUTI:
SI E PUSHTOI "GJENERALI..." I
KADARESË BOTËN E MADHE
TË GJUHËS ARABE

Nga Bajram Sefaj (fq. 7)

SHËNIME MBI LIBRAT

Rreth përmbledhjes me poezi "Është një vend që
quhet këngë" të Najwan Darwish

KUSH DO TË ISHA UNË
PA FJALËT E MIA?

Nga Besnik Mustafaj (fq. 12)

Duke lexuar romanin *Kronikat e mjegullës*,
të autorit Bashkim Hoxha

KRONIKA TRAGJIKOMIKE E
HISTORISË ME POROSI

Nga Skënder Karriqi (fq. 13)

PËRMBLEDHJA ME POEZI
"AS TERR, AS DRITË" E
ARDITA JATRUT

Nga Entela Tabaku (fq. 16)

CAMAJ

VEPRA



Onufri

DUKE IMAGJINUAR VERIUN E SHQIPËRISË NË ALPET BAVAREZE

(fq. 2)

Ky kontribut vjen me rastin e përkujtimit të shkrimtarit dhe profesorit Martin Camaj në 30-vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. (12. 03. 1992) Ky tekst është pjesa V e serisë "Letërsi e Ballkanit – Letërsi Botërore" të nisur nga Belfjore Qose dhe Christian Voss më 2021.


AVENTURA LETRARE E EPISTOLARIT TË ZARATËS

Nga Luan Rama

(fq. 18)

STALKER (ZONA E TARKOVSKIT)

Nga Andrea Tarka (fq. 20)



"KOMPOZIM ME TË KUQE DHE BLU" NGA PIET MONDRIAN

Dr. Bledar Kurti (fq. 22)

BIBLIOTEKË

Harry Martinson (fq. 15)

Drita e brendshme

Shqiptar Oseku (fq. 11)

Fushë beteje

Albana Shala (fq. 19)

Ritual dëshire

Enkelejda Kondi (fq. 19)

Dy zëra në një

EKSPERIMENTIMI I PARË FUTURIST NË SHOIPËRI

Dr. Prof. As. Anton Papeleka (fq. 14)

Onufri boton kujtimet e fotografit personal të Hitlerit

HITLERI ISHTE MIKU IM

Nga Heinrich Hoffmann (fq. 21)

10 poezi, nga Dmytro Chystiak
NË KËTË JAVË TË LUFTËS
TË SHKËMBESH LETRA
ME NJË UKRAINAS...

Nga Visar Zhiti (fq. 10)



Christian Voss: Arka e Noes e gënishtes

Do doja që sot të rilexonim veprën e Camajt, prandaj për këtë qëllim, sot kam ftuar tre studiuese brilante, të cilat po ashtu si Camaj, pozicionohen në udhëkryqin mes studimeve letrare, letërsisë dhe përkthimit: Belfjore Qose nga Tirana dhe Blerina Rugova Gaxha nga Prishtina/Gjakova, të dyja poetes të mirënjohura dhe njohëse të Camajt. Zuzana Finger është ballkanologe dhe një prej përkthyesve më të njohura dhe aktive të letërsisë shqiptare dhe kosovare në gjuhën gjermane. Të treja do na flasin për mënyrën se si e lexojnë dhe e shohin Camajn. Unë vetë jam studiues i sllavëve të jugut dhe ballkanolog në Universitetin e Humboldt-it. Do doja ta përdorja rolin tim si mikpritës në këtë takim në Zoom për të ngritur pyetje nga jashtë, që mund të hapin perspektiva potenciale, që mund të rezultojnë të paparashikuara.

Në që kemi interes për letërsinë shqipe e vemë re menjëherë se Martin Camaj është nga ato lloj artistësh shkalla e popullaritetit të të cilëve nuk mund të ishte më e ndryshme në Shqipëri/Kosovë dhe në Gjermani. Ndoshta është i krahasueshëm në këtë pikëpamje me Aleksandër Pushkinin, të cilin shumica e rusëve e konsiderojnë poetin e tyre më të madh, ndërsa shumica e lexuesve gjermanë vështirë se e njohin, pasi preferojnë të lexojnë romanet e njohura të Dostojevskit dhe Tolstojt. Sigurisht që krahasimi i Camajt me shkrimtarët rusë nuk është fort i gjetur, pasi Camaj është jo- apo edhe kundër-kanonik. Ndoshta kjo është arsyeja që admiruesit e tij më të zjarrtë janë të rinj. A depërton Camaj në çështjet më të rëndësishme të letërsisë së sotme transnacionale, të letërsisë së re botërore – e cila në një masë të madhe është shkruar prej shkrimtarëve të ekzilit dhe të migracionit – apo është thjesht një shkrimtar tradicional i vendlindjes (Heimatdichter), nostalgjik për vendin e tij? Dhe si mund ta zbërthejmë një shkrimtar ‘të vështirë’ idiolektik dhe hermetik? Çfarë na thotë ne Camaj sot? Në gjuhën gjermane ekzistojnë vetëm dy volume poetike të përkthyer nga Hans-Joachim Lanksch¹ dhe një fragment nga novela ‘Pishtarët e natës’, e përkthyer nga Florian Kienzle² në disertacionin e tij të vitit 2020.

Ndonjë prej trajnerëve për eficiencën e punës shkencore dhe krijuese do thoshte se Martin Camaj kishte deficit në përhapjen e tij, duke qenë se shkruante në një dialekt të një gjuhe periferike. Por qëllimi i Camajt nuk ishte shitja masive e librave të tij, përkundrazi misioni i tij ishte tërësisht i ndryshëm. Gruaja e tij Erika, gjatë një vizite në Lenggries në tetor të vitit 2021, me tha se ai thoshte “që shpëtoi gënishten”. Gjeta një formulim të ngjashëm në një shkrim të Lanksch-it (2010), ku Camaj citohet të

1 Martin Camaj, Gedichte: Albanisch-deutsch – Übertragen von Hans-Joachim Lanksch, München 1991;

Martin Camaj, Weißgefiedert wie ein Rabe – Me pendlat e korbis të bardhë, Gedichte Albanisch-Deutsch, herausgegeben und aus dem Albanischen übersetzt von Hans-Joachim Lanksch, Klagenfurt u. a. 1999.

2 Florian Kienzle, Ein Geben und Nehmen – Die Geschlechter in der albanischen Literatur, Wiesbaden 2020.

Ky kontribut vjen me rastin e përkujtimit të shkrimtarit dhe profesorit Martin Camaj në 30 vjetorin e ndarjes së tij nga jeta. (12. 03. 1992) Ky tekst është pjesa V e serisë “Letërsi e Ballkanit – Letërsi Botërore” të nisur nga Belfjore Qose dhe Christian Voss në 2021.

DUKE IMAGJINUAR VERIUN E SHOQIPËRISË NË ALPET BAVAREZE

Diskutim në podium për Martin Camajn

me BELFJORE QOSEN, BLERINA ROGOVA GAXHËN, ZUZANA FINGER,
të moderuar nga CHRISTIAN VOSS.

Aktiviteti është organizuar nga dega berlineze e Shoqërisë së Europës
Juglindore, në platformën ‘zoom’, më 14 dhjetor 2021.

Prezantim i shkurtër i Martin Camajt

Martin Camaj konsiderohet sot si një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm shqiptarë të shekullit XX.

Camaj ka lindur në Shkodër në vitin 1925 në fshatin Temal, në malësinë e Shkodrës. Pasi u arsimua në kolegjin Ksaverian, ai punoi si mësues. Ai u detyrua të largohet nga Shqipëria në vitin 1949 për arsye politike. Pasi qëndroi në Kosovë, ai u përkushtua studimeve sllave, romane dhe shqiptare në Beograd, para se të zhvendoset në Itali në vitin 1956. Sllavologu dhe ballkanologu Alois Schmaus ia doli ta merrte Camajn në Universitetin Ludwig-Maximilians të Mynihut, pasi ai mbrojti disertacionin e tij në Romë në vitin 196-. Fillimisht ai ishte student në Mynih, me pas lektor e më tej profesor me kohë të plotë dhe drejtues i Katedrës së Albanologjisë. Camaj ishte filolog dhe gjuhëtar, i cili dha një kontribut të rëndësishëm në historinë e dialektit geg (të folur në Shqipërinë e Veriut dhe prej të gjithë shqiptarëve në Ish Jugosllavi). Ai gjithashtu kreu kërkime shkencore për arbëreshët në Itali.

Ai ishte njëherësh një shkrimtar shumë prodhimtar: vepra e tij letrare sot përfshin dhjetë vëllime.¹ Në pamje të parë Camaj duket rasti i poetit nostalgjik për vendlindjen. Megjithatë, edhe pse ngjarjet në pjesën më të madhe të veprave të tij në prozë vendosen në malësinë e veriut, proza e tij shpesh bëhet surreale dhe fantastike. (Shih më poshtë: romanin “Rrathë”). Vepra e tij depërton në tema që janë përcaktuese për letërsinë e sotme të diasporës: interferenca kulturore, përkatësia dhe vetmia. Kështu që më poshtë do të diskutojmë se çfarë ka shqiptare, italiane apo gjermane në veprën e tij. Duke qenë shkrimtar në ekzil, Camaj zhvilloi idiolektin e tij pothuaj hermetik. Vështirësia e përkthimit të veprës së tij e ka penguar deri më tani receptimin ndërkombëtar. Në vitin 1993 miqtë dhe dishepujt e tij themeluan në Mynih “Shoqatën Martin Camaj”, e cila kujdeset edhe sot për veprën e tij.

1 Botimi i parë i veprës së Camajt është vetëpublikuar nga autori në Mynih gjatë viteve 1978 – 1981 dhe përfshin pesë volume. Kurse botimi i plotë i veprës së Camajt (10 volume) është botuar në Tiranë (Onufri, 2010).

ketë thënë “unë luftoj për gënishten”³. Do e përdor këtë pohim të thjeshtë, por shumë të rëndësishëm për t’iu përgjigjur pyetjes se çfarë na thotë ne Camaj sot. Si akademik, gjuhëtar, shkrimtar dhe poet, Camaj e shpëtoi gënishten, kjo ishte tërë puna e jetës së tij.

Do e kontekstualizojmë këtë në bashkëkohësi dhe do shtroja me pyetjen: Si lexohet Camaj 50 vite me pas? Një autor që donte të dokumentonte, të ruante kulturën e Shqipërisë së Veriut, të malësisë, të cilën ai e futi si një mesazh galaktik në një shishe dhe e hodhi në hapësirë. Çfarë

3 Hans-Joachim Lanksch, Der Dichter Martin Camaj (1925 – 1992) – Ein Porträt, in: Bardhyl Demiraj, Wir sind die Deinen – Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj gewidmet, Wiesbaden 2010, S. 24 – 45, cit. S. 45.

është moderne dhe çfarë është tradicionale në veprën e tij, siç do pyeste shkurtimisht Belfjore Qose. Para së gjithash obsesioni i Camajt për të shpëtuar gënishten mund të shpjegohet prej situatës së njohur politike të kohës. Regjimi totalitar e marginalizoi brutalisht gënishten, e cila simbolizonte shpirtin kozmopolit të Shkodrës urbane, me rrënjët e saj katolike dhe influencën shekullore italiane. Po për sa i takon Kosovës? Camaj kaloi shtatë vite në Beograd dhe përjetoi Jugosllavinë e hershme të Titos nën Aleksandar Ranković-in, që e kontrollon në mënyrë shtypëse Kosovën⁴. Duhet të jetë mahnitur dhe qysh prej fundit të viteve ‘60 e më tej, dhoma e tij e pritjes do ketë qenë plot me kosovarë të cilëve u është dhënë e drejta

4 Cf. Isabel Ströhle, Aus den Ruinen der alten erschaffen wir die neue Welt! Herrschaftspraxis und Loyalitäten in Kosovo (1944 – 1974), München 2016.

për të udhëtuar jashtë Jugosllavisë, pas ndryshimit pozitiv të qëndrimit ndaj gjuhës dhe kulturës shqiptare në Jugosllavinë e Titos të pas vitit 1966. Gjithsesi – dhe kjo është shumë e rëndësishme – ky ndryshim qëndrimi kishte të bënte vetëm me variantin standard të unifikuar të mbështetur në dialektin tosk dhe të folmet e Shqipërisë së Mesme, pasi elitat kosovare në fund të viteve ‘60 kishin votuar për adoptimin e këtij standardi nga Tirana.

Pavarësia e Kosovës padyshim solli përmirësimin e pozitës dhe ringjalljen e gënishtes, por përforconte makthin e Camajt, rënien e gënishtes si dialekt nativ i të gjithë shqiptarëve nën regjimin jugosllav dhe të atyre të Shqipërisë së Veriut. Një gjuhëtar si Camaj – që sigurisht i shihte gjërat më qartë se miku i tij Arshi Pipa në Shtetet e Bashkuara – e dinte se fundi i represionit ndaj një gjuhe minoritare dhe hapja e mundësisë për të qenë pjesë e maxhoritetit nuk kontribuon në jetësimin e një gjuhe, krejt e kundërta, ky është ekzaktësisht momenti kur fillon vdekja e një gjuhe. Sipas këndvështrimit tim përmes kontekstit historik shpjegohet pse Camaj i konceptoi dhe shkroi pjesën më të madhe të veprave të tij në vitet ‘70 dhe i botoi ato në një publikim shumë të shtrenjtë pesë vëllimesh në Itali në 1981-shin – kaq urgjent ishte misioni i tij për kohën.

Martin Camaj nuk do t’i besonte syve nëse do kishte llogari Facebook-u sot, ku mund të shihte sesi jo vetëm studentët e rinj, por edhe profesorë të Universitetit të Prishtinës përdorin variantin geg në mediat sociale. Si lidhet vepra e Camajt më çështjen aktuale të identitetit gjuhësor të shqiptarëve, që festuan festën e tyre kombëtare më 28 nëntor 2021, sërish me sloganin “një komb, një alfabet”? Kontributi i parë në këtë diskutim vjen nga Belfjore Qose, e cila jep mësim Letërsinë Botërore të sh. XX, pjesa I dhe Letërsinë Ruso-Sllave në Universitetin e Tiranës. Ajo gjithashtu është anëtare e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe mes botimeve të saj përfshihen edhe dy vëllime poetike dhe botime poetike në disa gjuhë të huaja⁵.

5 Belfjore Qose, Aurat e Natës (Auras of the Night), Tiranë 2017; Dritë. Luminance (Light. Luminance), Tetovë 2020.



Belfjore Qose: Martin Camaj mes modernitetit dhe tradiçës

Krijimtaria letrare në ekzil mund të jetë një formë e rikujtimit, rikrijimit dhe rikthimit të vendlindjes. Për mua pjesa më prekëse e "Ulksit" të Xhojsit nuk është fjalia e mirënjohur me "Po", ajo është në fakt një fjali e cila as nuk është pjesë e romanit. Është shënimi në fund "Trieste-Zurich-Paris, 1914-1921". Njësoj si gjeniu që transformoi Letërsinë Botërore edhe Martin Camaj e zhvilloi veprimtarinë e tij letrare dhe artistike larg Shqipërisë dhe vendlindjes së tij Temalit, 50 km në verilindje të Shkodrës. Kjo përvojë e formësoi thellësisht në mënyrë tragjike letërsinë e tij, duke na dhënë një prej imazheve të pashlyeshme të veriut arketipor shqiptar. Sikurse vetë Camaj pohon në intervistat e tij, ai nuk kopjon çka mban mend prej veriut, ai thotë se kujtimet që përdor më së shumti janë prej fshatrave arbëreshe, sigurisht të rikrijuar për t'iu përshtatur tërë qëllimit të tij artistik: rindërtimit të veriut arketipor. Itinerari i Camajt fillon nga Temali (1925 – 1935), Shkodër (1935 – 1946), Prekal (1946 – 1948), pas arratisjes në Jugosllavi ai vazhdoi studimet filologjike në Tuz dhe Pejë (1949 – 1950), Beograd (1950 – 1955) dhe Sarajevë (1955 – 1956); më pas ai jetoi në Romë (1956 – 1960) dhe së fundmi në Mynih dhe Lengries (1960 – 1992).

Camaj është magjepsës pasi vepra e tij ndërthur atë çka është thellësisht tradicionale, arkaike, etnike shqiptare me formën dhe strukturën e prozës dhe poezisë moderne. Kam zgjedhur ta cilësoj letërsinë e tij si "ekzuberancë e përkorë". Ai është modest pasi veprës së tij i mungojnë tërësisht notat patetike, amplifikimi i ndjenjave, ekspresiviteti i dëshirave, ndërkaq personazheve të tij u mungon po ashtu madhështia (tipike për heronjtë pozitivë të Realizmit Socialist). Përkundrazi, personazhet e tij ose janë duke u përpjekur, ose duke u transformuar apo në rënie. Mbi të gjitha, gjuha dhe stili i tij janë të përkorë. Kemi të bëjmë me një letërsi të përkorë, ku influenca hermetike shkon më së miri me lakonizmin e veriut. Nga ana tjetër jemi përpara formave moderne, të cilat Camaj është ndër të parët që i eksploron, nëse kemi parasysh Historinë e Letërsisë Shqipe.

Simboli si shtylla e figurativitetit të Camajt (shembull: korbi)

Në Itali kontakti me profesorin e tij, poetin e madh hermetik Giuseppe Ungaretti (1888 – 1970) e shënjoj Camajn poet. Poezia e tij me kohën bëhet me e thallë dhe priret më fort drejt metafizikës, duke përdorur simbole dhe imazhe tërësisht autentike. Camaj e ndryshon dhe pasuron kuptimin simboleve tradicionale që ripërdor në poezinë e tij. Simboli ishte mjete letrar i parapëlqyer i poetëve hermetikë dhe



teorikisht Camaj vepron po si ata, duke e çliruar fjalën nga përdorimi i automatizuar dhe semantika e saj e ngushtë. Ai i përdor simbolet e marra nga tradita shqiptare në kontekste dhe perspektiva të reja, duke i bërë ato të funksionojnë krejt ndryshe, në mënyrë më komplekse.

Ilustrimi më i mirë mund të jetë përdorimi i simbolit të "korbit", i cili për traditën shqiptare (ashtu si dhe për shumë të tjera) ka konotacion negativ. Krrokatja e korbit besohet se lajmëron fatkeqësi e ndoshta lajmi i një vdekje nuk vonon. Camaj e përdor këtë simbol në shtatë poezi, duke e ndryshuar kuptimin në çdo rast sipas interesit të tij estetik e duke e intensifikuar efektin tek lexuesi. Le të shohim dy poezi të mirënjohura me këtë simbol. Poezia e parë "Korbi", e shkruar në fazën e hershme të krijimtarisë poetike dhe "Një ditë e ka dhe korbi", një poezi e shkruar më vonë.

Poezia "Korbi" ka një natyrë narrative, pasi tregon historinë e një korbi i cili dëshiron t'i afrohet tokës, pavarësisht faktit se është i mallkuar të mos i afrohet kurrë asaj dhe banorëve të saj. Megjithatë, ai është duke u djegur nga etja dhe e mposht frikën ndaj njerëzve (atij i kujtohet se njerëzit e dinë që ai ha prej trupave të të vdekurve, madje sytë e tyre – çka është në natyrën e tij) dhe lëshohet tëposhtë. Në çastin që ai prek lirin (një tjetër simbol i fuqishëm në poezinë e Camajt), ai merr flakë dhe humbet nëpër qiell me shpejtësinë e rrafesë, për t'u gjetur të nesërmen prej barinjve "me kryet të bam thëngjill". Përpara se ai të digjet, ne njihemi me agoninë e tij "S'mujte korbi me pyetë vehten: / po unë tokës shka i kam vjedhë? / S'mujte korbi me ndie tjetër / në zemër të zezë vetëm frigë."

Në poezinë "Një ditë e ka dhe korbi" përdoret një imazh i kondensuar, e zeza e korbit në kontrast me të bardhën e pëllumbave. Korbi fshehtëzi sheh pëllumbat e bardhë, ai nuk bën zë sepse nuk do të prishë harenë e tyre dhe së në fund ndjen se "Kur te e vona pëllumbat kthyen në banesa / e ndjeu vehten korbi pëllumb në shpirt." Natyra evokative e Camajt përforcohet në

poezinë e dytë, pasi interpretimet mund të variojnë nga çështja e natyrës të së keqes, faljes dhe pajtimit, deri tek ajo e tjetërsimit apo alienimit, tema tipike të letërsisë moderne.

Dikotomitë tipike të Camajt

Thyerja midis individit tradicional, jeta e të cilit është thellësisht e mbështetur në kuptimin sakral që ai i jep botës përballë individit të ri modern, botëvështrimi profan i të cilit e zhvesh nga përmasa sakrale botën rreth tij – është një çështje që Camaj e trajton me shumë interes në prozën e tij. Ai dëshiron të zbërthejë në thellësi dallimin ontologjik dhe ekzistencial ndërmjet të vjetrës dhe të resë, në kontekstin kërcënues të "fabrikimit" të njeriut të ri komunist, i cili duhet të programohej për të qenë tërësisht i shkëputur nga tradita dhe spiritualiteti.

Në novelën "Shkundullima" dy personazhet kryesorë edhe pse janë të dashuruar, kanë vështirësi të madhe për të kuptuar njëri-tjetrin, të izoluar në botëkuptimin e tyre ata nuk arrijnë të depërtojnë në mënyrën se si tjetri e sheh botën. Ntonia jeton me "palimpsestet" e brezave brenda saj, ajo përjeton kohën ciklike, e cila është e pandryshueshme dhe veç përsërit veten. Jeta e saj ka kuptim tek përsëritja, jo tek ndryshimi. Vitoi, i cili ka jetuar në qytet dhe ka qenë i larguar nga fshati për një kohë të gjatë, është krejt e kundërta e saj. Për të gjithçka ka kuptim racional dhe sekular, ai dëshiron të sjellë ndryshimin në fshat. Për këtë arsye ai nuk është në gjendje të kuptojë pse Ntonia nuk mund të largohet nga kulla. Nëse ai do të rrijë me të, duhet të qëndrojë në kullë. Për Camajn fillimi nga asgjëja, pa histori dhe traditë është i pamundur, nuk mund të dilet prej rrethit të mbyllur. Prandaj kur Vitoi provon të ndërtojë një urë që do e lidhë fshatin me botën e madhe, fshatin e godet një tërmet i madh. Rendi metafizik nuk mund të ndryshohet, madje të tentuarit

për ta ndryshuar atë sjell këtë tërmet apokaliptik. I ashtuquajtur "progres" është një tentativë për të shkatërruar harmoninë e kohës dhe të hapësirës universale.

Struktura binare "këtu" dhe "atje" është e pranishme në disa prej veprave në prozë të Camajt. Një burrë dhe një grua prej vendesh të ndryshme dashurohen, njëri prej tyre jeton përherë më në veri se tjetri, qoftë ky fshat apo qytet, si për shembull tek "Rrunggaja në mars", "Shkundullima", "Rrathë" apo "Pishtarët e natës".

Romani "Rrathë" ("Rrathë uji", "Rrathë zjarri", "Rrathë gjaku")

Tek "Rrathë", romani më gjatë dhe për mendimin tim më i rëndësishmi i Camajt, Agoni (novelisti) është rrugës për në Ripën e Epërme (një vend fikcional), kur vëren (njëlloj si në novelën e sipërpërmendur) se koha dhe hapësira atje funksionojnë ndryshe. Agoni bëhet "peng" i një force misterioze që e mban atë në Ripë dhe ai nuk mund të kthehet më në qytet. Vetëm në fund të romanit ai arrin të kuptojë se ka kaluar 20 vjet në "vendin e vetmisë". Qenia e tij ndahet mes realitetit mitik, të pandryshueshëm, sakral dhe qytetit, i cili është duke ndryshuar dhe ku instrumentet e totalitarizmit vihen re kur shohim aksionet e një tjetër personazhi të rëndësishëm, Bardhit. Personazhi që jeton në iluzionin e së kaluarës është Baci. Ai ka krijuar *heterotopinë* e tij duke mbledhur tërë objektet muzeale që ka patur mundësi, në një muze të improvizuar në shtëpinë e tij. Kur muzeu shtetëror i merr gjithçka që ka mbledhur, ai e di se çdo gjë me vlerë për të do i merret njëherë e përgjithmonë dhe se tash e tutje, ato sende do jenë thjesht objekte, të tjerët nuk do munden dot ta kuptojnë vlerën e tyre. Baci hyn në një periudhë krizë prej së cilës nuk mund të shërohet. Ai nuk mund të përshtatet me modernen, kuptimi ontologjik për të qëndron në të kaluarën.

Romani "Rrathë" përfshin mjaft simbole që mbështeten thellësisht në kulturën tradicionale shqiptare, disa të rikrijuar e disa të marra ashtu siç janë nga tradita, duke e bërë rrëfimin e këtij romani një rast unik në letërsinë shqipe, përmes mënyrës sesi e ndërton raportin e tij mes imagjinare dhe reales. Kjo realizohet përmes narracionit modern dhe procedimeve kohore, të cilat krijojnë një botë mitike dhe reale, moderne dhe arketipale; një botë që ngrë dyshimin metafizik: po sikur gjithçka të jetë veç trillim?

Përvoja leximesh personale

Christian Voss: Do pyes tani Blerina Rogova Gaxhën dhe Zuzana Finger-in për të na treguar më shumë rreth përvojës së tyre leximore të Martin Camajt. Do doja të filloja me Blerinën, e cila punon në Universitetin e Gjakovës dhe është doktore shkencash në studimet letrare. Ajo është gjithashtu poetë dhe studiuese, në vitin 2015 ajo ka shkruar një vepër monografike për Ismail Kadarenë⁶. Në vitin 2021 është botuar monografia e saj "Vdekja në Letërsinë Shqipe Moderne – Ndre Mjeda, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli". Ajo ka fituar mjaft çmime letrare dhe është mjaft e pranishme në Europën Perëndimore, lexuesi gjerman e njej përmes kontributit të saj në projektin e traduktit "Archipel Jugosllavia", i cili përfshin tekste të ndryshme të kujtesës së folur të rinjve post-jugosllavë. Blerina ka shkruar tekstin "Jetë e lehtë", duke treguar perspektivën kosovare në këtë projekt (në fejttonin e gazetës Frankfurter Allgemeine Zeitung)⁷.

6 Blerina Rogova Gaxha, Gorgonë (Gorgo), 2009; Kate (Floors), 2013; Ajo vjen nga Lindja, 2016 dhe Thasë (Sacks), 2020.

7 www.faz.net/aktuell/feuilleton/buecher/archipel-jugoslawien/archipel-jugoslawien-beitrag-von-blerina-rogorova-gaxha-17222654/blerina-rogorova-gaxha-geboren-17230116.html




Blerina Rogova Gaxha:

Sipas leximit tim të Camajt, do thoja se Martin Camaj është një prej atyre poetëve të rrallë, fuqia e të cilëve vjen prej autenticitetit të tyre. Letërsia shqipe nuk ka asnjë shkrimtar tjetër të ngjashëm me Camajn, por mund të themi se ai është një pikë referimi për shumë poetë të tjerë dhe se influenca e tij është mjaft e dukshme. Unë jam njohur me veprën e Martin Camajt në një mënyrë shumë të veçantë, në formën e një surprize të bukur. Isha në vit të dytë të studimeve universitare dhe mbaj mend profesor Sabri Hamitin, një prej historianëve më të njohur të letërsisë shqipe, teksa na shpjegonte Letërsinë Shqipe Moderne. Ai shkoi përtej emrit të Martin Camajt, duke e konsideruar atë si një fenomen në vetvete. Ai foli aq bukur për veprën e tij, sa pas leksionit shkova në librarinë më të afërt dhe gjeta një përmbledhje me poezi të quajtura “Lirika mes dy moteve” (Munich, 1967). E lexova librin dhe u mahnita prej vargjeve të tij, prej gjuhës dhe prej pasurisë që i karakterizon poezitë e tij. Ato ishin vitet e para pas Luftës së Kosovës në 1998 – 1999 dhe më kujtohet se mjaft prej emrave të autorëve shqiptarë që më parë nuk përmendeshin, apo ishin mohuar, filluan të dilnin në sipërfaqe gjithmonë e më shumë.

Jam e sigurt se poezia e Camajt nuk lexohej në shkollë të mesme, ndoshta sepse unë e kam ndjekur shkollën e mesme gjatë luftës dhe ne nuk kishim tekste shkollorë, por mësonim prej leksioneve që na jepnin mësuesit. Nuk më kujtohet nëse e kemi mësuar Camajn apo nëse e kemi lexuar poezinë e tij, kështu që përvoja ime personale e leximit të Camajt filloi në universitet. U dashurova me poezinë e tij, me thellësinë e poezive të tij, me thjeshtësinë dhe bukurinë e gjuhës së këtyre poezive.

Duke qenë se ai jetoi në ekzil, unë e lexoj poezinë e Camajt si një udhëtim jetësor, ai është një lloj pelegrini modern, një udhëtar. Ai është Ulisi që nuk arriti kurrë në Itakë. Camaj e la vendin e tij që në moshë të re dhe gjithçka çka ndodhi përgjatë pelegrinazhit të tij nga ai moment e tutje ishte rikthimi në tokën e të parëve, në fakt për të mos ardhur më kurrë. Është një lloj udhëtimi shpirtëror drejt vendlindjes. Kështu më flet mua poezia e Camajt dhe prej fiksionit e deri në realitetin e ekzilit, poezia dhe udhëtimi i tij bëhen të pafundëm dhe kërkojnë të prekin thelbin esencial.

Letërsia e Martin Camajt është krijuar jashtë kufirit shqiptar, është letërsia e dikujt që u arratis, që u përdoq nga regjimi komunist, iku në Itali, në Gjermani, ku gjeti arratinë e duhur në punën e tij. Ai është zëri që udhëton nëpër botë dhe kthehet në vendin e tij si një jehonë, një zë nga ekzili. Camaj ishte i ri dhe i edukuar në frymën e lirisë dhe ndërgjegjes, prandaj refuzoi ta humbiste lirinë e tij shpirtërore, refuzoi t'i dorëzohej tmeritit ideologjik dhe çmimi i lirisë ishte largimi nga vendi i tij. Kjo duhet



ta këtë shkatërruar atë, por përtej këtij shkatërrimi, toka që la pas do e ndjekë atë përgjithmonë. Imazhi i kësaj Itake ulet në ndërgjegjen e tij, prej saj ai krijon shumicën e poezive të tij, ashtu si edhe hartën e tij shpirtërore dhe letrare. Ne e dimë se tema kryesore e poezive të tij lidhet me vendin, origjinën dhe kulturën e tij dhe se udhëtimi jetësor dhe poetik i Camajt e rikthen tek rrënjët e tij. E shoh tërë krijimtarinë e Camajt si mall për gjërat që humbasim në jetë dhe poezia është një portë që na çon në atë botë të humbur, tek gjërat që dëshirojmë, tek njerëzit që i kujtojmë dhe i duam.

Christian Voss: Do të vazhdojmë tani me Zuzana Finger-in. Ajo ka lindur në Çekosllovakia dhe sot jeton në Wilhelmshaven. Ajo është një prej ballkanologeve të fundit të shkollës së Norbert Reiter-it të Free University të Berlinit dhe ajo çka më duket më goditëse në rastin e Zuzanës dhe arsyeja pse e admiroj atë, është se ajo është eksperte shumë e mirë e studimeve ballkanike, por në të njëjtën kohë është një prej eksperteve të njohura të studimeve për Europën Qendrore. Doktoratura e saj e vitit 2000 është për komunikimin hungarez-slovak⁸ dhe bashkë me Armin Hetzer-in është autore e librit ndoshta më të mirë për mësimin e shqipes⁹. Sot ajo përkthen nga çekishtja, sllovakishtja, sllovenishtja, serbishtja, kroatishtja dhe shqipja në gjermanisht.

Zuzana Finger: Unë kam dy qasje ndaj Martin Camajt. Takimi i parë me veprën

⁸ Zuzana Finger, Die slowakisch-ungarische Kommunikationsgemeinschaft: eine Fallstudie, Wiesbaden 2000.

⁹ Zuzana Finger/Armin Hetzer, Lehrbuch der vereinehtlichen albanischen Schriftsprache, Hamburg 2019.

e tij m'u mundësua nga përkthyesi Hans-Joachim Lanksch (1943 – 2019). Lanksch-i, i cili ishte në Mynih asokohe, po ashtu më çoi në një takim të Shoqatës Martin Camaj në Lenggries¹⁰. Atje takova Erika Camajn, takova studentët dhe miqtë e Martin Camajt dhe përjetova atmosferën e shtëpisë së tij dhe të shtëpisë së tij birësuese në Lenggries, ne male. Unë kam studiuar ballkanologjinë në Berlin, kështu që rruga ime drejt Martin Camajt nuk ishte as e afërt, as e shkurtër. Por asoherë unë jetoja në Bavari dhe gjithashtu u bëra pjesë e Shoqatës Martin Camaj dhe për shumë vite përjetova takimet në shtëpinë e zonjës Camaj. Në këto takime na bashkonte vepra e Martin Camajt dhe zonja Camaj ishte shpirti i mirë i këtyre takimeve. Dy vitet e fundit këto takime nuk i kemi zhvilluar dot për shkak të pandemisë, por shpresoj se mund të vazhdojmë të takohemi me komunitetin e miqve dhe të admiruesve të Camajt ndoshta vitin e ardhshëm. Çelësi im i zbërthimit të poezive të Camajt ishin përkthimet në gjermanisht nga Hans-Joachim Lanksch-i. Më vonë, lexova edhe përkthimet në anglisht të Robert Elsie-së, të cilin e njihja personalisht, më vonë edhe përkthimet e Leonard Fox-it. Kështu, nisa ta lexoja Martin Camajn nëpërmjet përkthimeve të ndryshme, sepse në fillim kisha përshtypjen që gjuha e tij është paksa e vështirë për dikë që ka mësuar shqipen standarde. Për mua si lexuese rishtarë e Martin Camajt, më duhet të jem e sinqertë, ishte një sfidë e vërtetë. Veçse me kohë ndodhi e që m'u bë më e lehtë të zhytesha në gjuhën dhe fjalët e të menduarit të tij. Për këtë arsye, mendoj se problemi i qasjes gjuhësore është i zgjidhshëm. Me ç'kam

¹⁰ Për më shumë mund të shikoni faqen www.martin-camaj.de

lexuar e dëgjuar, së shpejti, do të nevojitet një fjalor i ri i letërsisë së Camajt në Kosovë. Shpresoj që kjo do ta ndihmojë shumë të lexuarin dhe të kuptuarin e letërsisë së tij.

Kjo ishte qasja ime personale, por në të njëjtën kohë, duke qenë se jam përkthyes, vuaj nga sëmundja profesionale e të lexuarit të cilitdo teksti nëpërmjet syrit të përkthyeses. Për këtë arsye, më shqetëson se si mund të sillet sa më pranë lexuesit gjerman Martin Camaj, si një emigrant shqiptar në Gjermani. Mund ta merrni me mend se qasja e gjermanëve ndaj Martin Camajt është krejt e ndryshme nga ajo e shqiptarëve. Ndjaj, u mundova të shihja në drejtime të ndryshme dhe më bëri shumë përshtypje kur mësova tani se fundmi se në Literarisches Colloquium në Berlin¹¹, ekziston një listë e autorëve letrarë të Berlinit që përfshin jo vetëm ata që shkruajnë në gjermanisht, por edhe ata që shkruajnë në gjuhë të huaj për tema gjermane.¹²

Po t'i biem pas idesë së të qenit një autor nga Berlini, mund të arrijmë në përfundimin, një ide shumë subjektive imja, se Martin Camaj ishte njëkohësisht shkrimtar shqiptar dhe bavarez. Nuk dua t'ia rrëmbëj kulturës shqiptare, por Martin Camaj e kaloi më shumë se gjysmën e jetës në Gjermani, në Bavari, dhe në këtë vend ai u bë një akademik i dorës së parë. Ai u martua me Erika Barbara Holer, pati të afërm gjermanë dhe po në Gjermani u maturua si shkrimtar. Ai ishte emigranti klasik por jo përfaqësuesi tipik i emigracionit politik, sikurse ka vënë re dhe Hans-Joachim Lanksch. Prandaj në shtëpinë e tij mendova se në poezinë e tij ndoshta kanë ndikuar malet e bukura të peisazhit bavarez. Sigurisht, shtëpia e tij shpirtërore ishte gjuha shqipe, por ai jetoi në malet bavareze, dhe ndoshta kjo e ushqeu dhe i dha forcën për të shkruar për vendlindjen e tij në një veri fantastik shqiptar. Gjithsesi, kjo është veç një ide hipotetike. Kjo ide më shqetëson sepse në një tekst të Hans-Joachim Lanksch-it kuptova sa e vështirë pati qenë për të që të botonte përkthimet e tij në Gjermani. Jam i bindur se nëse do ta shohim Martin Camajn kryekëput si një shkrimtar shqiptar, pa lidhjen e tij me kulturën gjermane, do të jetë shumë e vështirë ta përcjellim atë për lexuesit gjermanë nëpërmjet përkthimit. Nga ana tjetër, i jam shumë mirënjohës Hans-Joachim Lanksch-it që u shpreh se “Lirikat e Camajt mund të shijohen edhe nga lexuesi gjerman i poezisë që nuk ka njohuri për Shqipërinë ose nuk ka interes për historinë shqiptare. Kjo është atmosfera e veçantë e poezisë së Camajt për lexuesit, për shkak të temave universale të poezive të tij.”¹³

Përkthyeshmëria e Camajt

Christian Voss: Sipas këndvështrimit tim, të thuash që një autor është i papërkthyeshmë, do të ishte si të deklarohet falimentimin e filologëve. Sigurisht që “camaj-lekti” është një varietet i tij që askush nuk e flet. Nëse u hedhim një sy përkthimeve shumë të famshme të teksteve poetike, mund t'ju jap dy shembuj: I pari është rrëfenja e Igorit (Igorlied), një poezi e vjetër ruse e shekullit të 12-të, dhe a e dini se kush e ka përkthyer në gjermanisht? Rainer Maria Rilke, në 1906-n. Jam i sigurt që Rilke nuk e kishte njohurinë e rusishtes as në nivelin A2. Si ndodhi atëherë? Duhet

¹¹ Për më shumë mund të shikoni faqen <https://lcb.de>
¹² Senati i Berlinit gjithashtu ofron u ofron grante autorëve, duke e përkufizuar këtë status mbështetur në statusin e rezidencës dhe jo të etnisë apo kombësisë; cf. www.berlin.de/sen/kultur/foerderung/foerderprogramme/literatur/artikel.82132.php

¹³ <https://shkoder.net/camaj-lanksch/Hans-Joachim-Lanksch-Martin-Camaj-ende-i-pazbuluem>

që në një mënyrë a tjetër të ecësh hap pas hapi dhe në këtë mënyrë do të dëshiroja të shkonte me Camajn: nevojitet një poet që është shumë i interesuar për një përshtatje të lirë apo parafrazim (Nachdichtung), dikush i magjepsur nga cilësia poetike, por që ka zotësinë të bëjë një përkthim të papërpunuar. Shembulli i dytë është serbishtja dhe këngët epike në të folmen e sllavëve të jugut, që u përshtatën lirisht nga Johann Wolfgang von Goethe, Walter Scott-i dhe Stéphane Mallarmé-ja. Në kohët e romantizmit, kishte një magjepsje të skajshme për këtë folklor ekzotik, ndaj ata punuan me përkthimin ndërlinear. Kjo mund të ishte mënyra për të përkthyer Camajn, gjetja e një poeti që shkruan në gjuhën e synuar, të cilit do t'i interesonte të bënte një *Nachdichtung* në gjermanisht pasi t'i jepej një përkthim ndërlinear dhe tejet i fjalëpërfjalshëm. Kjo do të ishte pyetja ime për Zuzana-n: A është e mundur kjo – një dyshe poetësh dhe përkthyesish? A ju ka zënë veshi diçka të tillë në kohët moderne, apo është vetëm një model i shekullit të 19-të?

Zuzana Finger:

Jo, jo, kam dëgjuar për diçka të tillë. Për shembull, kemi rastin e Velimir Khlebnikov-it (1885 – 1922), një poet rus shumë eksperimentues i futurizmit, dhe shkrimtarit dhe përkthyesit gjerman Peter Urban (1941 – 2013). Fundjavën e kaluar lexova dhjetë interpretime të ndryshme të një poezie ruse nga dhjetë poetë të ndryshëm¹⁴. Kjo ishte një punë e përbashkët me poetët dhe Peter Urban, i cili bëri përkthimin ndërlinear dhe shpjegoi problemet gramatikore, strukturën gramatikore dhe poetët gjermanë shkruan poezi (një lloj *Nachdichtung*-u shumë të lirshëm).

Kujt i përket Camaj?

Christian Voss: Më pëlqeu komenti i Zuzana-s që Camaj që është poet gjerman dhe pyetja ime e parë provokuese është pikërisht në këtë kuptim: a mund të quhet pritja ndaj Camajt në Shqipëri dhe Kosovë një lloj përvetësimi kulturor? Ai nuk i përket fushës letrare në Shqipëri. Në fakt, ai godet si një kometë në vitet 1990, dhe kjo shpjegon magjepsjen e lexuesve të rinj prej tij. Pra, do të doja të krahasoja pritjet e ndryshme në Shqipëri dhe në Kosovë, sepse Shqipëria sigurisht që përjetoi monopolin e realizmit socialist. Ndërsa Kosova, duke nisur me shtëpinë botuese "Rilindja", bëri pjesë në kulturën e perëndimorizuar, kishte akses në letërsinë botërore në vitet 1970 dhe 1980 dhe përktheu, për shembull, Henry Miller-in në shqip. Pyetja ime për Blerinën është se si pritjet Camaj në Kosovë? A është ai një model për shkrimtarët në gegërisht? Dhe pyetja ime për Belfjoren është, a provokon Camaj një rikanonizim në Tiranë? Dhe a ka pretendime për të pasur një "Camaj tosk", për një version lehtësisht të aksesueshëm dhe "asimilues" të Camajt për shkollat fillore dhe tekstet shkollore, apo një "toskëzim" i tillë është tabu?

Blerina Rogova Gaxha: Camaj e nisi jetën e tij letrare në Prishtinë dhe u bë i njohur nga një botim në një nga revistat më të vjetra në Kosovë, me qendër në Prishtinë. Poezitë dhe librat e parë, "Nji fyell ndër male" në 1952 dhe "Kanga e Vërrinit" në 1955, i botoi në Prishtinë. Fillimisht, u dallua si poet nga Prishtina dhe me të vërtetë, edhe sot ka kritikë letrare që e konsiderojnë Camajn nga Prishtina, ndoshta sepse ky

14 Velimir V. Chlebnikov, *Beschwörung durch Lachen*, in: Peter Urban (ed.), *Velimir Chlebnikov – Werke*, vol. 1. Poesie, Rowohlt Verlag Reinbek 1972, pp. 19 – 25.

CAMAJ

VEPRA



Onufri

qytet i dha strehën e parë poetike si autor i botuar, apo ndoshta për shkak se dy librat e parë të botuar në Prishtinë janë bërthama e poezisë së tij të mëvonshme, siç e ka formuluar Anxhela Lepuri nga Universiteti i Tiranës, dhe parathënë identitetin e tij poetik për sa i përket stilit, formës dhe tematikës. Sigurisht, këtë na duhet ta shohim me relativizëm, sepse librin e parë e botoi në Prishtinë, lindi në Temal të Shqipërisë dhe kaloi në Gjermani pjesën më të madhe të jetës. Në këtë mënyrë, ai është dhe nga Shqipëria, dhe nga Kosova e Gjermania. E vërteta është që temat e tij janë universale, subjekti ka mall për gjëra, vende apo persona që ka humbur gjatë jetës.

Mendoj se jam pjesë e një brezi të ri poetësh. Librat e parë me poezi i shkrova në dialektin gegnisht dhe nuk isha e vetmja. Qemë disa poetë në brezin tim që pak-a-shumë eksperimentuam me gjuhën dhe nuk e pranuan standardin gjuhësor në poezi. Për kritikët letrarë kjo ishte tronditëse, sikurse ishte dhe mediatizimi ynë, por për mua Camaj ishte model se si të shkruaja gegnishten time vetjake. Ishte e ndryshme nga gegnishtja e Ndre Mjedës nga Shkodra (1866-1937), për shembull, një nga autorët që Camaj vetë e pati model për gjuhën, pikëpamjet gjuhësore, trajtën dhe përsosmërinë e gjuhës. Për mua dhe autorë të tjerë të rinj, ai ishte modeli i të shkruarit në dialektin tonë pa frikë, duke e përshtatur me standardin por duke përdorur gjithashtu paskajoren tipike të gegnishtes në mënyrën tonë, që të ndiheshim të qetë me veten. Me të vërtetë, ai ishte modeli i një brezi të ri poetësh që gjetën modelin e një gegnishtjeje nga më të shkëlqyerat në poezinë e tij.

Belfjore Qose: Para se të bëhesha

pedagoge në universitet, isha mësuese dhe u mësoja nxënësve të shkollave të mesme letërsi. Të gjithë nxënësit e mi e kuptonin gjuhën e Camajt. Duke u nisur nga kjo përvojë, gjuhën e tij do ta quaja një sintezë të dialektit të gegërishtes, sepse gjuha që përdor Camaj (dhe besoj fort në këtë gjë) nuk ishte veç mënyra e tij vetjake e përdorimit të gegërishtes, por një variant shumë i kultivuar i gegërishtes. Camaj donte të krijonte një model të gegërishtes letrare. Për mua, gjuha e Camajt është një gegërishte letrare e bazuar mbi traditën e së shkuarës së letërsisë shqiptare në gegërisht, ndërkohë që ai nuk përdor një gjuhë arkaike. Ndodh që ai zgjedh të përdorë fjalë të vjetra por gjuha e tij, në përgjithësi, është sintezë e traditës letrare në gegërisht dhe e dialektit të gegërishtes, por jo thjesht dialekti i tij i krahinës së tij. Kjo ka shumë rëndësi për mua sepse shumica e poetëve që shkruajnë gegërisht sot nuk ndjekin një parim të tillë. Ata përdorin të folmen e tyre. Në një nga letrat që Camaj i shkruante kritikut letrar shqiptaro-austriak, Krist Malokit (1900-1972), lexova se si Camaj, duke e krahasuar veten me të tjerë që përdornin gegërishten në idiolektin e tyre vetjak, thoshte që misioni i tij ishte krejt i ndryshëm. Ai dëshironte të krijonte një shembull të gegërishtes mjeshtërore.

Dëshiroj të komentoj atë që tha Blerina: është e vërtetë që Camaj ishte i panjohur për lexuesin shqiptar para 1990-s, dhe se u shfaq befas në ato vite si një fenomen i huaj. Ai ishte i panjohur dhe nuk bënte pjesë as në kurrikula e në asgjë tjetër. Por tani, situata është shumë e ndryshme, Camaj mësohet në shkollat e mesme që kur isha nxënëse. Dua

të ndaj edhe unë pëvojën time të takimit me veprën e Camajt. Kam lexuar poezi të tij, disa novela dhe romanin "Rrathë" që në shkollë të mesme. Po e përmend këtë, jo vetëm për të ndarë si përvojën, por të thënë që proza dhe poezia e Camajt paragjykohej si e pakuptueshme. Në fakt, letërsia e tij më pëlqeu jashtëzakonisht dhe romanin "Rrathë" e dashurova që në moshë të re. E lexova me kaq pasion, imazhet dhe ndjenjat që më ngjalli ishin kaq të forta, sa çdo pjesë të tij e kam të ngulitur në mendje. Gjatë rileximeve, sidomos për arsye hulumtimi, nuk kam e përjetuar kurrë me të njëjtin intensitet. Përjetimi i një veprë artistike është shumë më i çmuar se të kuptuarit e saj. Për këtë arsye, u them gjithmonë studentëve të mi se duhet të lexojnë para se gjithash veprën e Camajt.

E ardhmja e Camajlogjisë

Christian Voss: Cila është gjendja aktuale zhvillimore, për çfarë interesohen hulumtuesit e Camajt në Shqipëri dhe Kosovë? Si mendoni se ishte ndërveprimi dhe ndërhyrja midis dyzimit të Camajt si gjuhëtar dhe si shkrimtar? A bënte ai interpretime të shkrimeve të tij? Ekzistojnë komente të tij meta-letrare për romanet apo poezinë e vet?

Blerina Rogova Gaxha: Mendoj se ka interes për studimin e Camajt, si për një autor të madh, por me sa kam lexuar ka interes të veçantë për "Palimpsestin" e tij ose për qasjen ndaj tij nëpërmjet metodës ndërtekstore, diskursit dhe kuptimësisë, kujtesës së tekstit, kujtesës si kujtesë personale, si dhe për hulumtimin e gjuhës së tij, por edhe të vetmisë së tij kaq të veçantë, sidomos në poezi. Nisa të përmendja rrugëtimin e tij në jetë dhe poezi, pasi e shoh vërtetë si shtegtar, jo aq për shkak të atdheut të tij, por si një shtegtar modern që ngarend nëpër botë, një lloj shtegtimi shpirtëror që shpie tek temat universale.

Belfjore Qose: Një nga tiparet që duhet studiuar më tepër në veprën e Camajt është ndërtekstualiteti. Jo vetëm poezia por edhe proza e tij ka shumë shtresëzime. Edhe pse ai përdor tema universale si izolimi dhe vetmia, shtresëzimet e shumta në veprën e tij lënë shteg për lexime në shumë nivele. Për shembull, një mënyrë për ta interpretuar që ka qenë mbizotëruese bazohet te letrat që i dërgoi Camaj Krist Maloki, në të cilat ai theksonte tiparet psikanalitike të prozës së tij. Unë mendoj se kufizimi i interpretimit të Camajt vetëm te niveli psikanalitik, është kufizim i veprës së tij të gjerë e madhështore.

Zuzana Finger: Martin Camaj ishte studiues dhe akademik. Në parathënien e "Palimpsest" ai shpjegon arsyet e të shkruarit të kësaj poezie tejet intelektuale. Në fund të jetës, si gjuhëtar dhe studiues, ai i tha Hans-Joachim Lanksch-it se mund të shprehte pothuajse çdo gjë në shqip. Kjo ishte vepra e jetës së tij: të arrinte përsosmërinë e mjeteve të tij të të shprehurit në shqip. Ky ishte pasqyrimi gjuhëtarit në vetë letërsinë e tij. Veç kësaj, romanet e tij janë një thesar i vërtetë etnografik, një regjistrim i realitetit që vëzhgoi në qytezat arbëreshe, faqja etnografike e artit dhe prodhimt të tij letrar. Sigurisht që si shkrimtar, ai kishte lexuar shumë. Njihet influencimi i tij prej Giuseppe Ungaretti-t, por ka shumë konotacione të tjera, pasi ai vetë shpjegoi shumë qartë se ishte influencuar nga William Blake-u tek "Nema", nga Borges-i te "Palimpsesti", e nga T.S. Eliot-i te "Karpa". Mendoj se ai pasqyro vetveten, studiuesi i projektuar tek artisti në nivelin gjuhësor dhe shkencor.

Përktheu nga anglishtja:
ALBION ZIFLA

In memorim: Abdulatif Arnauti (13.01.1931 - 04.03.2022)

PROMOVUESI MË I MADHI LETËRSISË SHQIPE NË BOTËN ARABE

Nga Muhamed Mufaku

Më 4 mars 2022 u nda nga ne Abdulatif Arnauti, shkrimtari dhe përkthyesi shembullor, i cili promovoi letërsinë shqipe në gjuhën arabe për më se 70 vjet. Viteve të fundit, përveç halleve të moshës ai, sikurse shumica e banorëve në Damask, jetoi në izolim për shkak të luftës 10 vjeçare që kishte pasojat të rënda për shqiptarët e Sirisë. Kolonia shqiptare në Siri, e formuar para një shekulli, e kishte përfaqësues të vetin Abdulatif Arnautin, i cili tani ishte në mosën 91 vjeçare, pra gati sa moshë e kolonisë shqiptare atje.

Abdulatif Arnauti lind në Damask, në një familje të shpërmgullur nga Dobërlluka e Vushtrisë si pasojë e Luftës ballkanike, e përcjellë me shumë masakra në Kosovë kundër civilëve shqiptarë. Për në Damask u nis gjyshi Hasan me tre djemtë (Huseini, Abdurruahmani dhe Islami), dhe gjetën strehim në Lagjen e arnautëve, në veri të Damaskut. Husein kishte interesim për arsim. Por, atë që nuk arriti ta gëzonte për vete, u përpoq t'ua jepte deri në fund fëmijëve. Në këto rrethana u lindën dhe u formuan tre emra, që të bëheshin të njohur në Siri e jashtë saj: Abdulatifi, Abdulkadri dhe Ajshja Arnauti.

Abdulatif Arnauti ishte i pari prej djemve të muhagjerëve që kreu shkollën



e mesme dhe Normalen, duke punuar pastaj si arsimtar dhe drejtor shkolle, kurse më vonë kaloi në Ministrinë e Arsimit si sekretar i revistës al-Muallim al-Arabi (Mësuesi arab), të cilën e hapi për shkrime dhe përkthime nga letërsia shqipe. Rrënjët e shqipes së vjetër ai i zuri në familje, por e freskoi gjuhën me ardhjen në Damask të opozitës antikoministe nga Kosova e Shqipëria gjatë viteve 1946-1948, me poltikanë, intelektualë e ushtarakë (Xhafer Deva, Adem Dushi, Mul Bajraktari, Xhelal Bushati, Ismail Gorani e të tjerë).

Krahas punës si mësues e më vonë në

Ministrinë e Arësimit, A. Arnauti filloi herët të interesohet për prezentimin e letërsisë shqipe në gjuhën arabe në sajë të literaturës së re që arriti në Damask me opozitën antikomuniste. Kështu, në moshën 20 vjeçare e përktheu vjershën "Jetimi" të Ndre Mjedës, dhe e botoi në revistën siriane al-Janbu' më 2.7.1951. Një vit më vonë përktheu dhe botoi vjershën "Ngushllim" të Vehbi Ronës etj. Me këtë mund të thuhet se A. Arnauti është përkthyes i parë i letërsisë shqipe në Siri, kurse i dyti në nivel të botës arabe pas Vehbi Ismaili (1919-2008).

Abdulatif Arnauti u bë shumë aktiv

në vitet '60 të shek. XX në dy drejtime të ndërsjella: krijimi i poezisë së vet në gjuhën arabe me motive shqiptare dhe prezantimi i letërsisë shqiptare në gjuhën arabe, dukë përfshirë jo vetëm autorë të Rilindjes Kombëtare, por edhe të pas Luftës II botërore si nga Kosova dhe nga Shqipëria.

Në këtë drejtim ndikuan dy elemente që dhanë frytë më shumë në vitet '70 të shek. XX: vizitat e para në Kosovë (në Seminarin Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë e kulturën shqiptare) dhe në Shqipëri, përkatësisht takimet me shkrimtarët shqiptarë dhe këthimi në Damask me literaturë më të re të botuar në Prishtinë e Tiranë, si dhe puna e re si redaktor në revistën tremujore al-Muallim al-Arabi që e nxirrte Ministria e Arësimit. Tani me literaturë të re dhe me hapsirë për kuturë në revistën e përmendur A. Arnauti u afirmua më shumë si përkthyes i letërsisë shqiptare në botën arabe.

Në këtë periudhë letërsia shqipe e Kosovës gjeti rrugën e vet për lexuesin arab në sajë të punës së A. Arnautit. Në vitin 1971 ai përktheu dhe botoi dy vjersha të Jakup Cerajës dhe një tregim të Ramiz Kelmendit, më 1972 një prozë të Din Mehmetit, kurse më 1973 disa vjersha të Latif Berishës.

Viti 1974 shënon një zgjerim me rëndësi në angazhimin e Abdulatif Arnautit me paraqitjen e letërsisë bashkohore të krijuar në Shqipëri. Kështu, ai përktheu dhe e botoi në atë vit poemën e Ismail Kadaresë "Ditari i gjeneratës" si dhe poemën "Baballarët" e Dritëro Agollit. Më vonë edhe vjersha të Fatos Arapit.

Megjithatë, mund të thuhet lirisht se vitet '80 arrihet një kulm me përkthimin e katër romaneve të dy shkrimtarëve më të njohur të Shqipërisë në atë kohë. Më 1981 doli "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", më 1985 "Dasma," më 1986 "Kështjella" të Ismail Kadaresë. Kurse më 1985 "Njeriu me top" i Drirëro Agollit. Ato vite përkthyer me interesimin e madh për Kadarenë në botën arabe. Kështu që pas përkthimeve të A. Arnautit, u përkthyen dhe u botua disa romane tjera të Kadaresë prej frëngjishtes e anglishtes.

Ndërkohë, A. Arnauti nuk ishte vetëm përkthyes e promovues i palodhur i letërsisë shqipe në arabisht, por edhe figurë e njohur e kolonisë shqiptare në Damask me derë të hapur për shkrimtarët e gazetarët që shkonin gjatë dekadave të kaluara në Damask ose kaluan Damaskun në rrugë për Beirut e Amman etj. Si i tilë, A. Arnauti do të mbetet gjithnjë në kujtesë si mikpritës i mysafirëve nga bota shqiptare dhe promovues i kulturës shqiptare në botën arabe. Mund të thuhet lirisht se më shumë se 50 shkrimtarë të Kosovës dhe të Shqipërisë gjetën rrugën për atë rajon falë punës 70 vjeçare të A. Arnautit.

Për këto merita ishpresidenti i Shqipërisë Bujar Nishani e nderoi Abdulatif Arnautin me shtetësinë shqiptare në një periudhë që përkonte me kulmin e luftës në Siri dhe ai kishte nevojë të madhe për të udhëtuar. Ai u nderua po ashtu nga qeveria shqiptare në vitin 2012 duke u ftuar në festimet e 100 vjetorit të Pavarësisë.

Abdulatif Arnauti do të mbetet gjallë si sinonim i kolonisë shqiptare në Siri dhe si promovuesi më i madh i letërsisë shqiptare në botën arabe.



“Gjenerali...” - i Kadaresë ishte romani i parë që e lexova në gjuhën shqipe. Aq shumë u impresionova sa që, menjëherë vendosa që, nga gjuha shqipe ta përktheja në gjuhën arabe. Deri në atë kohë nuk kishte asnjë përkthim të asnjë romani të ndonjë shkrimtari shqiptar në gjuhën arabe”, thotë Abdul Latif Arnauti, sirian me origjinë shqiptare, përkthyes i veprës së Kadaresë në arabisht

- E bëtë përkthimin e veprave të Kadaresë në gjuhën arabe ngase konsideroni se Letërsia shqiptare nuk është e përkthyer sa duhet, apo nga bindja se gjuha shqipe që ka lindë këtë letërsi, duhet të lëmohet me tepër në rrethe kulturore botërore? Ja përgjigja e Abdul Latif Arnautit.

“Gjenerali...”, romani i parë shqiptar që foli arabisht

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, i shkrimtarit Ismail Kadare, ishte romani i parë që e lexova në gjuhën shqipe. Aq shumë u impresionova sa që, menjëherë vendosa që, nga gjuha shqipe të përkthej në gjuhën arabe. Deri në atë kohë nuk kishte asnjë përkthim, të asnjë romani të ndonjë shkrimtari shqiptar në gjuhën arabe. Kështu “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Kadaresë është romani i parë, jo vetëm i këtij shkrimtari, por përgjithësisht i letërsisë shqiptare përkthyer e botuar në gjuhën e botës së madhe arabe.

Botimin e këtij romani, në përkthim timin, e mori përsipër Ministria e Kulturës e Sirisë. Tre mijë kopjet e “Gjeneralit të ushtrisë së vdekur” në arabisht, që pa dritën e botimit në vitin 1978, u shitën pa u bërë një muaj i plotë. Kjo është dëshmia më e mirë se me çinteresim u prit ky roman i njohur i shkrimtarit shqiptar ndër lexuesit arabë të Sirisë, por edhe më gjerë. Kësaj duhet shtuar edhe shkrimet e shumta kritike. Për këtë roman u shkrua shumë dhe me lavd e mburrje. Edhe përkthimi im u vlerësua tejet pozitivisht. Meqë njëmend kisha dhënë çdo gjë nga vetja, duke u përpjekur maksimalisht që përkthimi im i parë të dalë sa më i suksesshëm, më vinte mirë kur kritikant, ndër të tjera, thoshin se, kishin fituar përshtypjen se “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur” e lexonin në origjinal. Një vlerësim i tillë, si për mua ashtu edhe për akëcilin përkthyes, është një mirënjohje e madhe dhe tejet e çmuar.

Emri i Kadaresë u bë shumë i çmuar në rrethe letrare e kulturore në mbarë botën arabe

I entuziazmuar nga suksesi i konsiderueshëm i përkthimit tim të parë dhe jehona që bëri ai në hapësirën e gjerë të botës arabe, fill pa “Gjeneralit...”, iu qasa përkthimit të romanit tjetër të njohur të Ismail Kadaresë, “Kështjella”. Edhe botimin e përkthimit tim të këtij romani në gjuhën

(Nga libri monografik “Përballë kolosit”, Shtëpia botuese “Faik Konica” - Prishtinë 2021, faqe 46- 51. Botohet me rastin e vdekjes së përkthyesit).

ABDUL LATIF ARNAUTI: SË PUSHTOI “GJENERALI...” I KADARESË - BOTËNË MADHE TË GJUHËS ARABE

Nga Bajram Sefaj



arabe, e mori përsipër, po sikur herën e parë, Ministria e Kulturës e Sirisë. Përkthimin tim të “Kështjellës” e botuan edhe në Kajro. Në Bibliotekën “El hilal” (Hëna e re) e cila boton veprat e shkrimtarëve më të njohur botërorë, “Kështjella” që u botua në njëzet mijë kopje, është shitur (atëbotë) menjëherë.

Pas suksesit, si të them, të papritur me këto dy përkthime, shpeshtova vajtje-ardhjet në Shqipëri. Të takohesha me shkrimtarët më të shquar shqiptarë, veçmas me Ismail Kadarenë dhe Dritëro Agollin, por edhe me poetë e shkrimtarë të tjerë të njohur. Atëbotë atje (pos “Gjeneralit...”) mora edhe poezitë e Kadaresë që, të përkthyer në gjuhën arabe, disa prej tyre i botuan gazetat dhe revistat letrare. Ministria e Kulturës e Sirisë u tregua e kujdesshme, i tuboi ato dhe i botoi në një vëllim të veçantë me titull “Kali i Trojës gjen vdekjen”. Kritikët,

edhe këtë vëllim me poezi, e pëlqyen shumë. Kështu emri i Kadaresë u bë shumë i çmuar, jo vetëm në rrethe letrare e kulturore, por në mbarë botën arabe.

“Dosja H” është romani i tretë i Kadaresë që unë e përktheva arabisht. Këtu, me duhet të bëj një lakim të vogël sqarues. Derisa Kadarenë tashmë gjithnjë e më dendur filluan ta përkthejnë, sidomos nga gjuha frëngjishte dhe ndonjë gjuhë tjetër, e veçanta e përkthimeve të mia ishte ngase unë veprat e shkrimtarit shqiptar i përktheja drejtpërdrejt nga origjinali, nga gjuha shqipe në gjuhën arabe.

Përmes Kadaresë arabët njohin kulturën, por edhe vetë popullin shqiptar

Letërsia titanike kadareane, natyrisht se është bërë e përbotshme, ngase ndërkohë është përkthyer dhe gjithnjë vazhdon të përkthehet, në shumë gjuhë të botës, por

unë, jo pa krenari, përsëris shpeshherë se në këtë drejtim, dhashë kontributin tim modest duke hapur rrugën përkthimit të veprave të tij edhe në gjuhën arabe. Nga se më parë, pra para shfaqjes së përkthimeve të mia të veprave të Kadaresë në gjuhën arabe, jo pjesë e kësaj bote të madhe as që ka pasur idenë e ekzistimit të gjuhës shqipe e lëre më të dije diçka më shumë e më për së afërmi për letërsinë e saj. Ta përkthesh veprën e Kadaresë në këtë gjuhë është punë tejet e vështirë dhe delikate. Gjithnjë e përherë duhet pasur kujdes e duhet gjetur kompromis më fatlume në përkthimin e teksteve (pjesët e tyre) që prekin fenë, por edhe politikën. Po të përkthehen ato siç janë në origjinal, sigurisht se nuk do ta shihnin dritën e botimit. Unë, ndërkaq isha i interesuar që ato të botoheshin dhe të depërtonin në këtë oqean të gjuhës arabe, të cilën sot e flasin mbi 250 milionë njerëz.

Falë punës së përkushtuar dhe tejet serioze në qasjen e përkthimit, kam arritur më shumë sesa që kam pritur. Nisa hullinë në lërimin e kësaj fushe të gjerë. Tash kemi një brez të ri të krijuesve sirianë me origjinë shqiptare. Muhamet Mufaku është ndër më të shquarit ndër t; ky është një autor e studiues i frytshëm i çështjeve ballkanike. Ata sigurisht se do të vazhdojnë dhe do t`i çojnë përpara, jo vetëm përkthimet, por edhe këmbimet dhe komunikimet letrare e shpirtërore përgjithësisht midis dy popujve. Unë vetëm sa kam hapur portën e vogël të kësaj rruge të gjatë. Ndryshe, përkthimin e shoh si televizionin sot: që nuk ka as havale, as kufij!

Bibliografi e Abdul Latif Arnautit

Abdul Latif Arnauti është i lindur në vitin 1931, në Damask të Sirisë. Rrjedh nga një familje shqiptare e Dobërllukës së Vushtrrisë, e cila, në vitin 1913, ka emigruar në Siri. A.L. Arnaut-i ka mbaruar studimet në gjuhën dhe letërsinë arabe dhe ka punuar në organe të shtypit letrar të këtij vendi. Ishte ndihmës kryeredaktor i revistës letrare “El maukef el Arabi” (Trashëgimet arabe). Abdul Latif Arnauti është shkrimtar, kurse librat e tij “Përtej maleve dhe deteve” dhe “Zjarri i mallit”, janë botuar edhe nga Rilindja në Prishtinë, kurse librin me titull “Flas për grua” ia ka botuar LSHA-ja e Shqipërisë, në Tiranë. Së shpejti, po ashtu në gjuhën shqipe, i botohet libri me titull “njëqind vajza dhe një grua në jetën time”. A.L. Arnauti tash është në pension, jeton dhe krijon në Damask të Sirisë.



Abdul Latif Arnauti duke vizituar Bibliotekën Kombëtare Tiranë, 2012

Etëhem Haxhiademi, poeti dramaturg, formim i cili gjeti shprehje më të plotë në tragjeditë klasike sipas modeleve greke e latine¹, jetoi përgjatë viteve 1902-1965. I magjepsur pas artit klasik, ai vuri me sukses në skenat shqiptare të asaj kohe shtatë tragjedi. Edhe kur ishte gjallë, pati kritikë që nuk e mirëpritën veprën e tij. Termi *haxhiademë dhe antihaxhiademë*², i përdorur nga V. Koça, e tregon më së miri këtë.

*"Kujt i drejtohet tragjedia klasike e Haxhiademit?"; "Përse Haxhiademi të mos i vinte një gur ma të shëndosh themelit të nisur nga Rilindja për theatrin t'onë kombëtar?"*³ - pyet në atë kohë nga Grenoblë e Francës, Dhimitër Shuteriqi, duke e menduar si të vështirë, si një vepër elitare e që kërkon njerëz me "ndjenja të holla" krijimtarinë e Haxhiademit. Po a ka gur më të fortë se sa kjo punë e vështirë që ka bërë Haxhiademi në teatrin shqiptar të asaj kohe, ku dramaturgjia në adresat e letërsisë shqipe, akoma nuk ishte shënuar.⁴

Cilat janë invariantet klasike që përdoren prej tij dhe si funksionalizohen ato në brendi të strukturës dramatike?

Në letërsinë shqipe, teatri nuk arriti asnjëherë ato zhvillime që mori proza dhe poezia. Gjinia dramatike është zhvilluar me hapa të ngadaltë, aty në gjysmën e dytë të shek XX. Në këtë periudhë kemi një sërë shkrimtarësh që përpiqen të krijojnë në këtë zhanër, por për krijimtarinë më të mirë në këtë fushë, duhet t'u kthehemi dramave klasike të Etëhem Haxhiademit, tani për tani të harruara.⁵

Etëhem Haxhiademi mund të konsiderohet si dramaturgu i parë në letërsinë shqipe, nga vlerat krijuese dhe për nga niveli i gjinisë dramatike për atë kohë. Kritika e pasviteve 90 mundohet të evidentojë vlerat e dramaturgut në radhët e krijuesve të letërsisë shqipe; kjo pas heshtjes që mbuloi veprën dhe jetën e Etëhem Haxhiademit në periudhën e diktaturës. Te *"Demokratia"* dhe *"Përpyqje shqiptare"*, bartëse të mendimit më të përparuar intelektual shqiptar, të shfaqur nëpërmjet lëvizjes *Neoshqiptare*, do të botohen herë pas here shkrime të Haxhiademit apo dhe kritika e njoftime për krijimtarinë e tij. *"Haxhiademi"*, thekson Aurel Plasari, *"jetoi në një periudhë dilemash të mëdha, për më tepër duke qenë dhe specialist i politologjisë dhe jurisprudencës, kuptonte më mirë lëvizjet e kohës."*⁶

Studiuesi Tomorr Plangarica, shprehet se për hir të mungesës, gjatë këtyre viteve vepra e tij është e *"njohur nga një brez i vjetër lexuesish"* dhe ka përcjellë tek ata *"një kënaqësi estetike"*, por duke qenë *"e kyçur... e ndrydhur... disi e mjergulluar në vetëdije, është e panjohur ose e njohur pjesshëm, te një brez i mesëm lexuesish"*.

Si i gjejmë fillesat e krijimtarisë së tij?

Interesi për teatrin i lindi që në moshë të *"ngjomë"*, siç do të theksojë vetë autori vite më vonë. E para vepër dramatike që i bie në dorë ka qenë drama *"Besa"* e Sami Frashërit, nga e cila i *"ngeli në mendje interesimi mbi veprat teatrore"*. Qysh nga

1 Robert Elsie, HISTORI E LETËRSISË SHQIPTARE, Zhvillimi i dramaturgjisë shqiptare deri më 1944, f. 248. <http://www.elsie.de/pdf/B1997HistLetShqip.pdf>

2 V. Koça, Përpyqja shqiptare. Gjendja mendore e kohës, Nendor, 1936, f. 202-203.

3 Dhimitër Shuteriqi, Përpyqja shqiptare, Zëri i të rinjve, "Për një drejtim letrar", v. 1 vol. II, Tiranë 1937, f. 103.

4 Robert Elsie, *Shqiptarë vazhdojnë të bashkëjetojnë me fantazinë* - Intervistë, Drita, 3 gusht, 1991, f. 4

5 Robert Elsie, HISTORI E LETËRSISË SHQIPTARE, Zhvillimi i dramaturgjisë shqiptare deri më 1944, f. 249. <http://www.elsie.de/pdf/B1997HistLetShqip.pdf>

6 Aurel Plasari, *Portreti i vonuar i tragjikut Etëhem Haxhiademi*, Drita, 9 qershor 1991.

PËRDORIMI I MITEVE KLASIKE NË TRAGJEDITË E HAXHIADEMIT

Nga Migena Kapllani

ajo kohë, *"dëshira për t'u ba ma vonë autor dramash, nuk u shkull kurrë"*.

Në Tirol të Austrisë, gjatë vazhdimit të studimeve, u njoh me autorët grekë e latinë. Magjepsja pas artit antik, e shtyn shpejt të shkruajë të parën tragjedi, *"Ulisi"* (Berlin 1924). Në të mundohet të përcjellë një vepër që i përmbahet temës mitologjike, por të patrajtuar më parë nga autorë të tjerë, siç thotë dhe vetë autori *"tue besue se asht adapte për të dalë një tragjedi në frymën e Eskilit"*, pasi në këtë kohë tragjeditë e kollosëve të antikitetit, *"i kishin marrë zemrën e ba për vetë"*. Është pikërisht tema e trajtuar në këtë tragjedi që më vonë i dha Etëhem Haxhiademit emrin e *"Sofokliut shqiptar"*. Substanca mitike, klasike, parabiblike apo historike, nëpërmjet universalitetit të saj, gjen vend për pasqyrimin artistik të botës shqiptare të kohës.

Kështu lexohet realiteti shqiptar edhe kur përdoren heronjtë e mitologjisë, *"Ulisi"* dhe *"Akili"*, valenca simbolike e të cilëve është e lidhur ngushtësisht me ngjarjet e kënduara prej Homerit, po kështu edhe kur përdoren mite të historisë shqiptare të konotuara

7 Etëhem Haxhiademi, *"Shënime mbi jetën time"* (dërguar L. Poradecit), Fondi personal, 9 prill 1938.


në simbolikën e tyre në Ballkan, (*"Pirrua"*, *"Aleksandri"* dhe *"Skënderbeu"*), ashtu dhe kur përdoren personazhe si *Abeli* dhe *Kaini*, ngushtësisht të lidhur me situatën mitike të vëllavrasjes.

Miti klasik i "Akili" dhe "Ulisit"

Te tragjedia *"Akili"*, apo dhe *"Ulisi"*, shihet dora e pastërvitur e një dramaturgu, ku, siç thotë dhe vetë autori, *"ndihen ende gjurma djalërie..."*. Ndjehet në këto tragjedi mahnitja ndaj mitologjisë dhe dëshira për t'i sjellë në vëmendje mite që ende nuk janë të vënë në skenë, si rasti i historisë së vdekjes së Odisesë (Ulisit). Tamam si dikush që adhuron atë që lexon dhe do të tregojë çdo gjë, autori e rëndon veprën *"Akili"* me tregimet e plota të miteve, siç është ai i dasmës së Thetidës dhe *"Mollës së sherrit"*, apo i thembrës së Akilit.

"Shpirti i tragjedis 'Akili', asht ahmarrja: çdo njeri qi vret sa do i fortë me qenë, në funt do ta pësojë", thekson dhe vetë autori.

Tragjedia ndërtohet brenda kampit trojan, ku jepet hakmarrja e Priamit ndaj Akilit, duke e mësuar Paridin si ta vrasë duke e goditur në pikën e dobët të tij. Në



vepër, më tepër se personazhe (gra e burra të antikitetit), autori përcjell ambientin e kohës së tij. Historia e dashurisë së Akilit me Poliksenën (vajza e Priamit) sjell vajzën, femrën e ndrojtur, që mezi pranon ndjenjat e saj para të atit, që i druhet syve të njerëzve në takimet me Akilin: *"asht turp po t'rrijm' kështu për na të dy, këndeje ndonji njeri na paft me sy"*.

Niveli artistik, temat e marra nga antikiteti, mitologjia, zgjedhja e dy personazhëve kryesorë të Homerit me landë të patrajtuar më parë, (historia e Ulisit është përmendur nga Aristoteli si vepër e Sofokliut, po vepra është zhdukur⁸), problemi i fatit të njeriut, i grindjeve dhe hakmarrjes, mbështetja në tragjeditë antike të Eskilit dhe Sofokliut, i bëjnë të përafërta këto dy tragjedi; *"Akili-n"* dhe *"Ulisi-n"*. Fakti i përdorimit të mitit për shpjegimin e ngjarjeve reale historike, sipas Alfred Uçi ka çuar në një *"falsifikim"* të kuptimit dhe përmbajtjes fillestare të miteve.⁹ Vetë dramaturgu do të shprehet: *"...landa e tragjedis sime 'Ulisi' asht lufta e njeriut me fatin. Çka asht thanë nga orakulli do të përmbushet dhe njeriu nuk ka si shpëton"*. Në fakt, elementi hyjnor del në tekst vetëm nëpërmjet orakujve, kur Ulisi merr vesh dhe i parathuhet se do të vritet nga Telagoni, djali i tij me Circen. Bardhyl Matraxhiu për tragjedinë *"Ulisi"* thotë: *"Ndërsa në veprën e Sofokliut, atëvrasja vjen si rezultat i fatalitetit hyjnor, në tragjedinë e Haxhiademit nuk ndihet prania e hyjnive. Atëvrasja aty është rezultat i rrethanave të rastit dhe sidomos i nervozizmit, xhelozisë dhe grindjeve që kanë hyrë në familjen e Odisesë."*¹⁰

Tragjeditë e historisë shqiptare: "Aleksandri", "Pirrua", "Skënderbeu"

Tragjedia *"Aleksandri"* (Lushnjë 1928) është tragjedia e tretë për nga numri, por e para për nga vlera. Së bashku me *"Pirron"* (Gjirokastrë 1934) dhe *"Skënderbeun"* (Gjirokastrë 1935), ato të trija i bashkon tema e zgjedhur nga historia kombëtare, siç përmendet në parathëniet e veprave. E. Haxhiademi për nga vlerat thekson *"me një besim të patundur"* se tragjedia *"Pirrua"*, *"do të mbesë kryevepra e Melpomenës shqipe"*. Autori i qëndron besnik ngjarjeve të cilave i referohet. Tragjedia *"Aleksandri"*, tragjedi e rivalitetit të dy grave, e çoi një familje drejt fatkeqësisë. Këto ngjarje të shkëputura nga historia e lashtë e Epirit, përcillen me vërtetësi dhe nuk janë aspak *"manipulime"* dhe *"zëvendësime mitologjike"*, por vërtet *"të veshura me një pasion të egër: lakminë për pushtet"*¹¹. Tragjedia *"Aleksandri"* fitoi "Çmimin e Mbretit" në garat teatrore, zhvilluar në Tiranë. Po në të njëjtën temë, të ambicjes për pushtet, ku ndjehet

8 Aristoteli, *Poetika*, Buzuku 2003, f.84.

9 Alfred Uçi, *"Fryma rekonstruktive dhe anakronike e letërsisë mitologjike"*, *Mitologjia, folklori, letërsia*; Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1982, f. 318.

10 Bardhyl Matraxhiu, *Kritikë e tragjedisë dhe tragjedi e kritikës*, "Nëntori" 7/1991, f.105.

11 Alfred Uçi, *"Fryma rekonstruktive dhe anakronike e letërsisë mitologjike"*, *Mitologjia, folklori, letërsia*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1982, f. 318.



Portret i E. Haxhiademit nga skulptori Bujar Kapllani

Dear Dmytro Chystiak,
We've talked about you, about Ukraine, about the children, about your poetry, we're keeping you and your loved ones in our prayers...

Ka një javë që ka filluar lufta mes Rusisë dhe Ukrainës dhe unë kam një javë që i shkruaj një profesori të ri ukrainas në Kiev, është poet, me të cilin jam njohur në Itali, i them që ne ashtu si e gjithë bota jemi të shqetësuar për ju, për Ukrainën, për fëmijët, lutemi që të pushojë lufta, etj, dhe ai më përgjjet:

Dear Visar, thank you so much for your kind words. We are in Kyiv under the air attacks but hoping to survive, pra më falenderon që i shkruaj, është në Kiev nën sulmet e avionëve dhe shpreson të mbijetojë, se e prët jeta, e presin punët.

Tronditëse dhe e rëndë. Më kujtoi për një çast letrat që dërgonim nga burgu, por nuk kanë të krahasuar, ata janë në luftë, nën bombardime, lidhja me me botën, mund të ndërpritet, ndërkaq tani mund të thonë ç'të duan me guxim, dhe të komunikojnë virtualisht, kurse ne ishim të mbyllur, robër, pa liri dhe s'na lejohej të shkruanim si të donim, por si donte komanda e burgut. Edhe ne ishim të kërcënuar nga vdekjet në minierat e rënda, nga ushtarët me armë në kullat përreth televe me gjëmba, kur kursesi nuk ka të krahasuar me luftën. Por burgjet tona ishin sipas atij programi që vinte nga Moska, e cila tani ka nisur ushtrinë e saj të pushtojë Ukrainën.

Dhe tani me një poet atje ne shkëmbejmë mesazhe, ai më çon pamje nga nata përreth e tij e përflakur nga bombardimet. Jemi njohur në Itali, na bashkoi poezia në qytetin e bukur të Veriut me liqenin parajsor me të njëjtin emër Como, që atij i duket sikur i përket një tjetër jete, kështu me shkruan. Isha me time shoqe, Edën, ishte dhe një tjetër shqiptar mes poetëve nga bota, poeti nga Kosova, Jeton Kelmendi, bisedonim me Dmytro Chystiak dhe me presidenten e festivalit, poeten Laura Garavaglia, bënim plane për shumë poezi mes nesh...

Dhe ka një javë që ka filluar lufta dhe duket sikur ka ndryshuar jo vetëm jetë njerëzish në Ukrainë dhe Rusi, por në të gjithë njerëzimin. Filozofi gjerman Theodor Adorno tha se pas Aushvicit e si mund mund të shkruash më poezi... Po, për Aushvicin, për Spaçin, për luftën në Ukrainë tani.

E gjithë bota është e shqetësuar se Ukraina, populli i saj, po luftohet nga shteti ngjitur, Rusia, me delirin stalinist të Bashkimit Sovjetik, të supershtetit të dikurshëm perandorak komunist. Ukraina po qëndron duke u bombarduar e shkatërruar e djegur, por me dinjitetin njerëzor të atij që nuk do që të bjerë, ka të drejtën e jetës, të lirisë, që ta bëjë si e do populli isaj, pa dëmtuar popuj të tjerë, se shtetet janë si njerëzit, megjithëse Rusia nuk është e gjithë si car Vladimir Putini e përkrasësit e tij. Sa po i dalin kundër?

Shpesh themi që bota është bërë më e vogël, për të kuptuar që janë shtuar njohjet mes vendeve dhe popujve dhe njerëzve, komunikimi në kohë reale, rrugët drejt njëri-tjetrit, takimet, shpejtësia e tyre marramendëse, të qenit pranë me ndihma, me shpirt, me lutje dhe poezi, pra s'ka si të mos besohet se njerëzorja ka një shtrirje planetare...

Por bota është bërë e vogël dhe në kuptimin tjetër, ka mbetur e egër në absurdin e saj, e gatshme për mizorira të pabesueshme për shekullin XXI, e vogël në egoizmin e shteteve si të njerëzve të tyre, që edhe pse shtojnë diturinë, mbeten parakë deri dhe në mosmirënjohjen shkatërrimtare ndaj të përditshmes njerëzore, thënë shkurt, në fund të fundit ndaj tjetrit.

U bë java e luftës mes Rusisë euroaziatike dhe Ukrainës evropiane dhe televizionet kanë lajm të parë këtë, deri edhe bisedat

NË KËTË JAVË TË LUFTËS TË SHKËMBESH LETRA ME NJË UKRAINAS...

Nga Visar Zhiti



e zakonshme në tryezat mes miqsh e ato familjare. Është shqetësimi për të ardhmen e përbashkët. Bota është bërë e vogël. Por Ukraina bombardohet, e sulmon ushtria, që të kujton kryqin e thyer, por të kuq dhe ikin njerëz, dhe nga vendi i sulmuar, për të mbrojtur jetën, por dhe nga vendi që sulmon, intelektualë e qytetarë që nuk e durojnë turpin e të qenit të një vendi vrasës. Shkencëtarë dhe artistë, priftërinj të shumtë të ortodoksisë ruse i shkruajnë letra Putinit, që të heqë dorë nga lufta, nga kjo çmenduri tragjike. Ndërsa në Ukrainë, që nga Presidenti i vendit, e deri te çdo burrë e grua janë mobilizuar të mbrojnë vendin, aty janë dhe artistët, shkrimtarët, balerinë të njohur e deri te vajzat, fituese si mis të bukurisë. Botë moj, mos e vrit bukurinë tënde!

Putin nuk e duron dot afrimin e Natos deri te dera e vendit të tij, kujton dhe një marrëveshje që Nato-ja nuk do të duhej të zgjerohej me vendet e Lindjes ish komuniste, ato të Traktatit të dikurshëm të Varshvës, tani të zhbërë, por më e rëndë është shkëlja e sovranitetit të vendeve të tjera, të pavarura, të tradhtosh demokracitë e tyre, kur Nato-ja ka për qëllim dhe mbrojtjen e demokracisë, jo vetëm të anëtarëve të saj, por dhe të

popujve që e thërrasin dhe e kërkojnë këtë ndihmë.

Kur Europa po harronte Luftën II Botërore, në Europë po vriten njerëz mes dy shteteve, njëri në rolin e pushtuesit e tjetri të atij që nuk do të pushtohet, që duket sikur duan të afrojnë një luftë të tretë, internacionale, përfundimtare, besohet.

Po vriten njerëz jo vetëm në frontet e luftës, por dhe në rrugë dhe në shtëpitë e tyre, që befasi shndërrohen në gërmadha dhe pallatet ndahen përgjysmë e shëmben, ndërsa bodrumeve dhe në metrotë e stërmbushura me njerëz që duan mbrojtje, qan sfida, lindin fëmijë.

Në shtëpinë e tij në Kiev është dhe Profesori i letërsisë, poeti Dmytro Chystiak, madje nuk lëviz nga tryeza e punës dhe lufta nuk duket se ka një javë që ka filluar, por vite. Edhe shekuj mbase. Brenda njeriut...

Librat i kë venë në dritare, që të mos duket bendësia e shtëpisë, thotë në një intervistë, dhënë një televizion të Kosovës, linkun e së cilës ma nisi mua. Lufta jonë i ngjan asaj të Kosovës, vazhdon ai, ka po ata heroizma, të fitojmë dhe ne e të bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian. Edhe Kosova është pjesë e kulturës evropiane, duhet ta njohë sa më parë shteti i Ukrainës. Ndërkaq

shton se ka ndër duar një libër studimor për poezinë shqipe, me shpresë që ta mbarojë, po t'i shpëtojë luftës... Dhe më nis imazhe plot flakë...

Është ndjellje për mirë, shpresë që në mesazhet që shkëmbejmë me Dmytro Chystiak, ne i kemi dërguar dhe libra njëri-tjetrit, flasim dhe për poezinë dhe unë i kam treguar dhe për meshat në kishën pranë shtëpisë në Chicago, ku vazhdimisht lutemi për Ukrainën, që lufta të ndërpritet sa më parë. Dhe ai beson më shumë në dashurinë njerëzore, kur i them që po përktej poezi të tij, nga libri "Det në gur", botuar vitin që shkoi në Itali, është pjesë e luftës për të qenë njerëz, për t'iu gjendur pranë atyre që janë të rrethuar nga lufta dhe shkatërrimi. Natyrisht poezia s'është as bukë e as ilaçe e as gjak e plumba, por poezia është njeriu.

CILI ËSHTË NJERIU DMYTRO CHYSTIAK?

Poet nga Ukraina, prozator i tregimeve të shkurtra, historian i artit dhe i religjionit, kritik letrar, frankofon dhe përkthyes, një fytyrë e pastër rinore, që di të qeshë përzemërsisht. Ai është profesor në Universitetin Kombëtar të Kievit, "Taras Shevchenko" (poeti kombëtar i Ukrainës, i përkthyer herët në shqip, shkëlqyer nga Jorgo Blaci, që e çuan burgjeve, më pas diplomat në Rusi).

Dmitry Chystiak është antar në Qendrën Evropiane të përkthimit letrar në Bruksel, përgjegjës në Shtëpitë botuese ukrainase "Summit-Knyga" dhe franceze "L'Harmattan". Ka botuar 65 libra, gati dyfishin e moshës së tij, disa prej të cilëve të përkthyer që nga Azerbajxhani pranë, në Belgjikë, Bullgari, Francë, Hungari, Japoni, Maqedoni, Serbi, Moldavi, Rumani dhe Kosovë. Është fitues çmimesh ndërkombëtare. Është dhe Sekretar Ndërkombëtar për Letrat e Akademisë në Universitetin Evropian të Shkencave, Arteve dhe Letrave të Parisit. Është emëruar si Kreu i Urdhrit të Arteve të Ukrainës dhe Kalorës i Urdhrit Francez të Palmës akademike.

Dua të them se ka gjithë këto punë. Ç'do lufta në shtëpinë e tij?

Poezia e tij është lirike, e paqtë, ruan dhe format klasike dhe rimën muzikore, ia pashë në origjinal dhe jam mundur të jenë dhe në shqip, ai është trashëgues i traditës së poezisë së vendit të tij, përdorues dhe i vargut të lirë, me imazhe dhe metafora si në poezinë moderne evropiane dhe amerikane. Është i hapur.

Ja, disa. Nuk janë nga poezitë e kësaj jave lufte, as aq, por më shumë. A është aty parandjenja? Gjithçka ndodh më parë te poetët



10 POEZI

poezi nga Dmytro Chystiak

* * *

Po të sjell jargavanët e mbrëmjes
Që të vdekurit kishin mbjellë:
Kur shiu i artë do të na bashkojë
Do t'më rrëmbesh me një ëndërr të
përflakur
Që do të përziejë çastin dhe do ta
ndryshojë
Dhe jargavanët e mi nuk do të kenë më
lotë.

* * *

Të ftohtë janë lumenjtë dhe hijet e
pemëve
Dhe alarmi i erës mbi flatra.
Ti tundesh në gjoks nga kambanat e
hershme
Mes syve je tempull përjashta.

Dhe duart dolën lart mbi ecjen
Dhe Rruga e Qumështit mbi ëndrrën.
Ra kaq shumë shi mbi jetën
Sa qielli dhe toka desh u çmendën.

Gjatë përmytjes le të kthehen varkat,
Kopshtet rrëzohen në një pikë të ngrirë.
Gjithçka lundron në dashuri si tek fjala
Dhe uji i lartë do na përtërijë.

* * *

Kaq shumë duar na mbanin në pranverë,
Por të tuat janë hapur për Pashkë.
Kush e ktheu rrjedhën në humnerë
Dhe tingulli ndrit i dënuar në flakë.

Zëri yt i qetë e ftohu gjakun,
Oferta e rëndësishme e bëri të bukur.
Bisha mes yllësive e kërkon gjahun
Dhe trupi ynë – një rreze e këputur.

Bora bie dhe ç'shtiza vërviten
Dhe tokat shkrihen në ujrart anëve.
Fytyrat dridhen në fjalët që ikën
Dhe lutem në rretjen e krahëve.

NATA NË VENECIA

Kjo kishë në gjumë mes nxitimeve
Nën erërat kërcënuese, oh!
Në këtë vjeshtë mes shkëlqimeve,
Më puth dhe më mashtro.

Në qiell selvitë fluturojnë
Nën mermer të bardhë gjithë qetësi.
Ëndërroj në qytetin me borë:
Më puth dhe më fshih.

S'je këngë, por jehonë pranvere,
Si vajzat ndrit yllësia e gjerë.
Kur agimi hap krahët prej mjellmë,
Më puth dhe më lerë.

* * *

Dritë e agimit do sjellë heshtje.
Ende fle me krahët e hapura,
Fryma gjithnjë e më etëshme
Mes blerimeve të lagura.
Stuhi purpuri janë përçafimet,
Prarime rrushi në dritare,
Fryma e detit në blu hidhet
Në kufijtë e tu delikate.
Ç'shi do t'na e ndriçojë
Ditën e kuqërremtë erracake.
Përpara se drita të shuhet,
Zëri mbytet në përmytje balte...

Por nëse dita nuk vjen më
Në kufijtë e tu delikate?

* * *

E di që do të mjaftonte gjesti i dorës,
që të zhduken zogjtë fërgëllues
Që pluhurosën me ar shkumën e këtyre
ujërave.
Rrugës tënde s'i duhet më jehona,
por nuk di si të të le,
Dhe muri i muzgut lejon
Dritën tënde smerald,
Brigjet hapen në vështrimin tënd,
Pavarësisht psherëtimës së lamtumirës në
fjalët e tua
Ndërsa ti i adhuron këta zogj valltarë
Ndjej ngrohtësinë tënde kundër viteve
Që papritmas bërtasin dhe qajnë në brigje,
Por drita jote smerald ende rrjedh
Deri sa ne të kthehemi
Në zogj hijesh dhe floriri mbi lumin ku
lindëm.

* * *

Mami, ja ku je fundosur në vreshta,
një plagë digjet mbi një plagë tjetër.
Sa shumë pemishte në rrethina,
breshri bie, thyen pasqyrat e bardha,
gjaku blu nuk rrjedh më
nga burimi në kishë.
Fytyrat mavi në netët e vdekura
Dalën si sythat e akullit,
fëmijët shenjohen, flokët e pastër,
puna e rreme e prerjes së gurëve.
Në këtë hënë prej zambaku, ky lot
Duket si shiu, fëmija dhe vesa.

* * *

Pret perëndimin e diellit,
po këtu është dielli i korbave
dhe zëri i borës është këtu,
megjithatë kufijtë të lënë të qëndrosh,
kape tingëllimën e qiejve
dhe përndrite kalimin tënd të përulur,
para se të përndriten humnerat.

KAMBANAT E NJË VJESHTE QË ECËN

Për Michel Otten


Ti ecën mbi varre
Dhe zëri i artë i kopshtit
Kumbon për të vdekurit e gjallë:
*Guri i varrit të pret me vitin e pagëzimit
dhe e gjithë jeta s'është veçse një rrugë
drejt gjetheve të vdekura...*
Kaloj varret:
shkretëtira të frikës dhe të lojërave
dhe ja, në sytë e tu sërish
është ajo freski e së shkuarës që vjen.
Fëmijë diellorë përshkrijnë lumenjtë e
fildishtë.

MBI BUZËT TONA BIEN YJE

Përtej fluturimeve, baticave
Kjo heshtje, kjo bardhësi vëllazërore,
Me premtimin e një lumi përjetësie,
Me tmerrin e egër të pamjeve tona:

Kryq na përçafon hardhia e vjetër,
Yjet bien mbi ne, zgjerohet e gjitha.
Nën det qiejsh nga ëndrra në ëndërr
Zërin e saj ka gjetur pemishtja.

Përktheu nga italishtja Visar Zhiti



ky ari ka vrarë më parë

mund ta kuptosh nga mënyra si sillet
se ky ari ka vrarë edhe më parë
pjellë të veten
në emër të dashurisë
ka putra të rënda të prindit brutal
që dashuri s'njeh
e kërkon respekt
qenie turiegër nga guva historie
të merr në grykë në përçafim mortor
pa t'i thyer eshtrat
s'të lëshon
pa ta marrë frymën
s'të lëshon
kurrë

fushë beteje

si materniteti
si parashkollorja
si kopshti
si bashkia
si zyra
si kisha
si spitali
si oborri
si familja
si shtëpia e fshatit
si kati i nëntë

zi

pikëllimi është kjo familje
që ecën heshtur në rresht për një
drejt kufirit të ndarjes

fushë beteje

5 poezi për Ukrainën

nga

Shqiptar Oseku

ti mbijeton

duke nisur lista fjalësh të ndaluara
si avionë letrash
për t'i ulur diku ndër poezi

midis ciflash të ftohta të dimrit
një butësi në vendbanimet tua
që parathotë pranverë

Ukraina ime

(palimpsest me fjalë nga
Volodymyr Zelenski)

1.
Të gjithë po mendoni se jeni larg
Jo, jeni në një trevë lirie
2.
E kur pragu i lirisë dhunohet e shkelet
Duhet të na mbron
Se ne po shkojmë të parët
Por ju jeni të dytët
Se bisha sa më shumë të hajë
Uritet aq më shumë
e më shumë
e më shumë
3.
Unë jam këtu
Është e imja S'e lëshoj
Qyteti im
Bashkësia ime
Ukraina ime

Rreth përmbledhjes me poezi “Është një vend që quhet këngë” të Najwan Darwish

KUSH DO TË ISHA UNË PA FJALËT E MIA?

Nga Besnik Mustafaj



Palestinezi Nexhvan Dervishi (Najëan Derësh) është sot një nga zërat më të spikatur të poezisë botërore. Me botimin e tij të fundit në anglisht “Exhausted on the cross” ai ishte finalist për çmimin kryesor, që jepet në SHBA për poezinë e përkthyer, atë të American PEN Centre, i cili u shpall para një jave.

I lindur në vitin 1978, palestinez që jeton brenda shtetit të Izraelit, në Haifa, ai ka botuar deri tani shtatë libra me poezi dhe është përkthyer në afro 20 gjuhë. Jo vetëm identiteti i tij formal, por edhe mbiemri i tij sjell vetvetiu në vëmendje njërin nga poetët më të mëdhenj të shekullit XX, Mahmud Dervishin. Nexhvan Dervishi u shfaq me librin e tij të parë “Ai trokiste në derën e fundit” pikërisht në vitin 2000, si për të shënuar kështu edhe në kalendar se do të ishte poeti i shekullit XXI, sado që nuk do të mund t’i shpëtojë kurrë lidhjes semantike me paraardhësin e vet të lavdishëm, të cilin nuk e evokon asnjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë me sa kam parë në përmbledhjen e zgjedhur “Është një vend që quhet këngë”, përgatitur dhe përkthyer mjeshhtërisht në shqip nga Muhamed Mufaku, botuar nga Instituti për Studime Orientale në Prishtinë, ndërkohë që evokon në poezi të veçanta shumë emra të ndritur të filozofisë, letërsisë dhe kulturës arabe të traditës apo edhe bashkëkohorë. Por, trashëgimia e Mahmud Dervishit është e shpërndarë gjithandej si limfë në poezinë e Nexhvan Dervishit, më konkretisht si estetikë e revoltës, diçka e ngjashme me përcjelljen e ADN-së të paraardhësve të njeriu.

Pikërisht kjo “estetikë e revoltës”, guximi poetik dhe njerëzor për ta kundërshtuar hapur dhe pa kompromis të keqen përbën gjithashtu një farë kurthi kur është fjala për të folur mbi poezinë e tij. Duke njohur dramën e Palestinës në histori dhe aktualitet, duke parë edhe vullnetin e poetit për t’u identifikuar me këtë dramë, vjen vetvetiu një shtysë për t’u përqendruar te poezitë me këtë temë, gjë që do ta reduktonte tej mase zbulimin e hapësirës imagjinative të Nexhvan Dervishit. Ky është kurthi i lehtësisë. Nën një vështrim të tillë, kjo vepër poetike do të shqyrtohej për mesazhet e saj politike e morale, por që në fjalë të fundit, sado të pasura e të fuqishme të jenë, ato e ndriçojnë veprën vetëm pjesërisht, duke dhënë një përshtypje krejt të pamjaftueshme për vizionin e poetit mbi botën dhe njeriun. Për shkak të zgjedhjes së kësaj lehtësie, Nexhvan Dervishi e ka parë me siguri shumë shpesh veten të lavdëruar nëpër faqe gazetash anembanë botës si qytetar palestinez me integritet të lartë. Poezitë e cituara në këso rastesh sillen kryesisht si “provë” e virtuteve të poetit. Pra, poeti, me jetën e tij, paraqitet dashje pa dashje si më i rëndësishëm se vepra e tij letrare. Në

vlerësimin tim, kjo do të ishte një padrejtësi në dëm të poezisë. Pavarësisht qëllimit të mirë nga ana e autorëve të recensioneve të tilla, ngushtohet rruga e poezisë për të shkuar te lexuesit e vërtetë, me të cilët poeti dëshiron natyrshëm të vendosë një lidhje besnikërie afatgjatë. Shembulli i Nexhvan Dervishit më ndihmon për të tërhequr vëmendjen drejt një problemi që e kanë në përgjithësi poetët dhe shkrimtarët e ardhur nga vende të vogla, por me histori dramash të mëdha politike apo sociale. Qasja ndaj veprës së një poeti amerikan apo francez nuk ndikohet në përgjithësi për mirë e as për keq nga jeta qytetare apo politike e autorit.

Për ndërtimin e kësaj antologjie, Muhamed Mufaku ka zgjedhur kriterin kronologjik duke sjellë një tufë me poezi nga secili prej librave. Sigurisht që edhe në këtë rast, si në hartimin e çdo antologjie, subjektiviteti i nismëtarit ka patur ndikimin e tij. Gjatë përzgjedhjes, Muhamed Mufaku është udhëhequr natyrshëm nga pëlqimet e veta për poezinë. Por jo vetëm. Ai ka mbajtur gjithnjë mirë parasysh qëllimin e lartë për ta paraqitur poetin para lexuesit shqiptar sa

më denjësisht. Nexhvan Dervishi pranohet sot botërisht si njëri nga poetët më të rëndësishëm bashkëkohorë. Rrjedhimisht, hartuesi i antologjisë është mbështetur edhe në vlerësimet e kritikës më serioze letrare botërore, përfshirë prestigjiozën “New York Book Rivieë”, e cila, përveç vështrimeve rast pas rasti mbi poezinë e Nexhvan Dervishit, ka nxjerrë edhe vetë si botues në vitin 2014 një përmbledhje të zgjedhur me titull “Nothing more to lose” si dhe një tjetër në vitin 2021 me titull “Exhausted on the cross”. Duke i besuar shijes së vet, por edhe vlerësimeve të kritikës letrare, Muhamed Mufaku na ka sjellë në shqip një antologji mjaftueshmë përfaqësuese për poetin në kuptimin që ne, lexuesit shqiptarë, arrijmë të shohim aty një poet të madh dhe ndjejmë dëshirën ta zbulojmë më tej veprën e tij. Nga ana tjetër, duke zbatuar kriterin kronologjik në hartimin e antologjisë, Muhamed Mufaku na e ka thjeshtuar ndjekjen e rritjes së tij si poet nga libri i parë “Ai trokiste në portën e fundit” në vitin 2000, kur ishte 22 vjeç, deri te libri i shtatë “Kur u zgjuam një herë në parajsë” në vitin 2020. Është një rritje e pandalshme, që ka sjellë zgjerimin e

vazhdueshëm të vizionit të tij poetik ashtu edhe pasurimin e gjuhës. Nisur nga mosha e tij do të thosha me gëzim të veçantë se poeti Nexhvan Dervishi, për fatin e mirë, është ende vetëm në mesin e rrugës. Nëse do të bënim një skicë të kësaj rruge, ajo do të fillonte si një përrua malor, që vjen duke u zgjeruar e mbushur me ujë për t’u qetësuar në fushë, ku bëhet lum i ngjashëm me Nilin në udhëtimin e vet të pakthyeshmë drejt detit.

Nuk është vendi këtu për shqyrtime të thelluara mbi poezinë e Nexhvan Dervishit. Shumë shkurtimisht po i lejoj vetes të tërheq vëmendjen e lexuesit vetëm te gjuha e tij. Mbështetur te kjo përmbledhje, do të kisha thënë se Nexhvan Dervishi duket të jetë një poet aristotelian, sipas të cilit poezia është arti i gjuhës. Në përpjekje për një përcaktim i përshtatshëm për këtë gjuhë do të kisha thënë se ajo është “thelbësore”. Gjuha poetike e Nexhvan Dervishit është, pra, thelbësore. Ai zotëron një mjeshtri të lartë për ta bërë gjuhën në vetvete të padukshme. Domethënë, vëmendjen e lexuesit nuk e tërheq bukuria e fjalëve si të tilla apo tingëllima e tyre, ai nuk bën lojëra metaforash dhe as akrobacira gjuhësore. Ai nuk është një poet eksperimentalist e as formalist. Mundimi i Nexhvan Dervishit, - do thënë një mundim i shpërblyer mirë -, shkon në gjetjen e fjalës së saktë për të shprehur pa humbje mendimin dhe përfytyrimin e tij origjinal të shkrirë në njëri - tjetrin.

Kësisoj, gjuha e tij është skajmërisht e kursyer, aspak aproksimative dhe, më së shpeshti, shumëkuptimëshe. Pikërisht kjo shumëkuptimësi e vendos lexuesin në atë rrethanë, kur ai nuk kujtohet për gjuhën në vetvete, por për përmbajtjen e tekstit poetik si unitet koherent, njësoj siç ai nuk kujtohet për dritën e diellit, por për botën e shfaqur para syve të tij, edhe pse kjo botë është e prekshme për shqisat e tij vetëm në sajë të dritës së diellit. Kësaj veprë do t’i shkante përcaktimi i një tjetër poeti të madh, Oktavio Paz, i cili thotë diku se poezia nuk është e pakuptueshme. Ajo është e pashpjegueshme. Si e kuptueshme, por e pashpjegueshme, poezia e Nexhvan Dervishit mishëron një hermetizëm të shëndetshëm, modern dhe larg çdo spekulimi. Nuk më duket se poeti ka arritur te një rezultat i tillë në mënyrë thjesht intuitive apo spontane, sado që intuita ka me siguri vendin e vet të rëndësishëm në procesin e tij krijues. Por ai shfaqet krejt i vetëdijshëm për identitetin si poet, që ia jep pikërisht gjuha. Madje, ka dëshirë edhe t’ia pohojë lexuesit, kur në një poezi, pyet: “Kush do të isha pa fjalët e mia?” Nuk është një pyetje, përgjigja e të cilës do të përmbledhej në një fjali. Domethënë se ai (poeti) është gjuha, stili i tij. Aristoteli do t’i thoshte se stili është vetë poeti. Ndaj gjuha e tij është kaq thelbësore.

PEN AWARD FOR POETRY IN TRANSLATION (\$3,000)

For a book-length translation of poetry from any language into English.

Judges: Caro Carter, Michael Favala Goldman, Parisa Saranj

Exhausted on the Cross, Najwan Darwish (New York Review Books)
Translated from the Arabic by Kareem James Abu-Zeid
[Bookshop](#)

Everything I Don't Know, Jerzy Ficowski (World Poetry Books)
Translated from the Polish by Jennifer Grotz and Piotr Sommer
[Bookshop](#)

I Name Him Me: Selected Poems of Ma Yan, Ma Yan (Ugly Duckling Presse)
Translated from the Chinese by Stephen Nashef
[Bookshop](#)

Outgoing Vessel, Ursula Andkjær Olsen (Action Books)
Translated from the Danish by Katrine Øgaard Jensen
[Bookshop](#)

Ova Completa, Susana Thénon (Ugly Duckling Presse)
Translated from Spanish by Rebekah Smith
[Bookshop](#)

poezinë europiane, se prej saj ka vazhduar t'i vijë edhe në periudha të shkuara ai gjak jetik që quhet qytetërim perëndimor, në rastin tonë - modernitet.

Pavarësisht nga zgjidhja e kësaj çështjeje: a është apo nuk është vërtet i pari tekst futurist i botuar në vendin tonë, poezia *Shqipëri!* e Lele Gjinit (në mos pastë emër tjetër), e meriton të përfshihet në antologjinë shkollore si dhe në çdo antologji panoramike. Me risitë që sjell, me shtegun e ri që hap, për të vazhduar pushtimin estetik të botës, ajo është pjesë e traditës sonë të gjallë e jetëgjatë. Margaritar i humbur në një bodrum, e pavënëre nga syri i historiografëve të letërsisë, i antologjistëve, i kritikëve, kjo lirikë nuk është fosil apo relike. Në një kohë kur plot vjersha që botohen aktualisht në organe shtypi a në libra, mbajnë në ballë gjurmët e llahtarshme të vdekjes, poezia *Shqipëri!* ka mbijetuar, për të na mahnitur me risinë, njomësinë dhe aktualitetin e saj.

Rizbulimi dhe rivlerësimi i kësaj lirike më shtyn të mendoj për një çështje që e pezmaton jo pak jetën tonë letrare: vlera e vërtetë estetike mund të mënjanohet për njëfarë kohe, mund të lihet në harresë nga padituria ose në mënyrë të qëllimshme, por vjen një ditë kur kjo vlerë e mënjanohet, e harruar, del në dritë dhe integrohet në trashëgiminë e breznisë a të periudhës letrare përkatëse. Dhe atëherë për poetin që nuk rron më fizikisht, në vend të formulës rituale: «I ndritë shpirti!», duhet thënë: «I ndritë fjala!», çka fundja është e njëjta gjë...

Për të bindur lexuesit që besojnë lehtë, por sidomos ata që janë skeptikë, se gjithë ç'thashë deri tani, nuk është panegjirizëm i pathemeltë, po u vë përpara tekstin integral, të cilit i kam hequr vetëm apostrofin te dy pronorë.

LELE GJINI

SHQIPËRI

(Lyrismë futuriste)

Shqipëri:

Fjalë e kaltërtë
E pëshpëritur n'Apir
Nga kjo racë jetike,
Që ka gjithëmonë
Një poezi të re për të krijuar,
Një lavdi të re për të fituar!

Shqipëri:

Paraverë syllabesh
Të lulëzuara si trëndafilë
Në kopshtet arbërore,
Ylluar si flolat qiellore
Të bëra me harqe blu të çkufizuar!

Shqipëri:

Emër i ynë dhe i bijvet tonë
Rrugë e vetëme e dashurisë sonë
Çerdhe e shkundërmuar e mendimevet
Puthje e fundit mbi sytë tona
Në ditën kur vdekja
Do vijë ngadalë!

(Ujdisur nga Italishtja)

Referenca bibliografike

1. Nazif Mamaqi, *Burbuqet e Pranverës*, Tiranë 1933
2. Roland Barthes, *Le degré zéro de l'écriture*, 1972, f.37
3. N. Mamaqi, vep. e cit.
4. Eqrem Çabej, *Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes*, Tiranë 1994, f.79
5. Arthur Rimbaud, *Poésie*, Paris 1993, f.88
6. Borhes, *Poezi*, Tiranë 2000, f.194
7. *La poésie moderniste*, Paris 1992, f.32
8. Ismail Kadare, *Shekulli im*, Tiranë 1961
9. Fatos Arapi, *Shtigje poetike*, Tiranë 1962

DRITA E BRENDSHME

poezi nga Harry Martinson (Çmimi Nobel 1974)

Përktheu: Qerim Raqi

NATË QERSHORI

Tani dielli është duke perënduar me shkëlqimin e tij na verbon Kufiri i muzgut bëhet orë e agimit as e hershme as e vonë

Liçeni bartë dritën e mbrëmjes duke rrëshqitur nëpër pasqyrën e ujit apo nëpër valët me dyshim të cilat shumë para se të errësohet reflektojnë agun e ditës me rrezim

Nata e qershorit kurrë kurrë s'përfundon i ngjan më shumë një dite me vesë ngrihet në perëndim si një mbulesë dhe ikën tutje në detëra ndriçon

MBRËMJA NË FSHAT

Enigmë e heshtur pasqyrohet rrotullon mbrëmjen në qetësi kallami. Këtu është një lehtësi që askush nuk e vëren në pëlhurën e barit. Bagëtia e qetë që shikon me sy të gjelbër. Ecin mbrëmjes së qetë deri poshtë tek uji. Dhe liçeni u jep ujë të gjitha gojave me lugën e tij gjigante.

RRËFIMI I KËNGËS

Ka gjëra që as nuk duam t'i dimë as t'i besojmë: se lulet janë të verbëra, se hëna ka vdekur,

që zambaku i ujit kalbet deri në vjeshtë. Lyra ka këngën e saj. Ndjenja ka lojën e saj me gjuhën. fjala me fjalën në rrathe duke kërcyer gjirore e tyre në mjegullën e pyllit të kuq të hënës. Një gjuhë endacake e ëndrrave në të cilën kërkohet dhe jepet kënaqësia për shkak të dëshirës për një mirësjellje zbukurose kundër vdekjes gjithmonë të sigurtë të shëmtuar të kalbur. Përballë këtyre perspektivave, fjalët bëhen spontanisht kukudhë. Përrallë e modës së vjetër që lëkundet me fundet e saj të zambakut. I goditur nga njohuritë, i shqyrtuar. Ende e gjallë, duke u ngjitur në marramendje nën besimin e vet dhe duke kërcyer me radhë në tonet e kësaj loje të gjuhës sonë luginës së natës.

DHIMBJA E MADHE

Ligjet e natyrës janë tashmë në rrugë për të na vënë të gjithëve për muri. Ky mur është ligj i natyrës. I mungon ungjilli. Dhimbjen e madhe duhet ta ndajmë të gjithë. Atëherë bëhet e mundur ta mbajmë. Trishtimi i madh është pikëllimi i madh. Këtë duhet ta mësojmë të gjithë.

Është dhe duhet të ekzistojë një domosdoshmëri për të gjithë.

Të gjithë duhet të mësojnë të ndjejnë dhembje për botën.

Kur njeriu tani ka fuqi të mjaftueshme për t' i shkaktuar pikëllim botës atëherë ka ardhur koha për të kuruar me kohë pikëllimin e botës para se e gjithë natyra të bëhet një fëmijë pikëllimi i të gjithëve.

Ky quhet kujdesi në kohë. Dhimbja e vërtetë që me kohë vrojton dhe kupton.

DHEMBJA DHE GËZIMI

Çdo dhembje e thellë ka gëzimin e humbur si qëllim Mos e humb këtë drejtim

Mos e lërë dhembjen ta harrojë detyrën e saj, dhembja është nderi më i madhë që gëzimi mund ta ketë.

DRITA E BRENDSHME

Në hapësirat e brendëshme, në më të voglat, luhet një lojë e heshtur dhe e vazhdueshme ngjyrash e pakapshme për syrin Është drita e mberthyer që dikur në çastin e krijimit lindi nga brenda dhe qëndroi aty në lëvizje pasi të jetë ndarë në spektrin më të vogël sipas ligjit prizmatik me shifra të përziera që nga ata që shohin do të quhej ngjyrë nëse ndeshen me sytë që shohin. Ato lëvizën periudha jashtëzakonisht të vogëla kohore e hapsinore e megjithatë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për intervalet më të vogëla. Në fakt dukej sikur kishin mjaft kohë e hapësirë. Cikle të tëra nanosekondash dhe nanohapësirash prej dritës së bardhë deri te ngjyrat e spektrit dhe përsëri te drita e bardhë. Një lloj frymëmarrje e dritës.

Fotonet merrnin frymë dhe pulsonin me njëra-tjetrën ndërironin shenjat dhe nivelet. Kështu drita mbahej në lëvizje në drejtpeshimin spektroskop nga dritë e dendur në atë ndarëse dhe prapë në dritë të dendur dhe ndarëse në cikle spektrore pambarimisht në përsëritje.

Ishte si një lojë erashke sipas ligjit të njëjtë që vlenë për ylberë, por me erashka të hapura dhe të mbledhura që këmbeshin me njëra-tjetrën sipas një ligji të dritës që ishte i shkruar. Ishte drita kur vallëzon mbështjellur kur e brendshmja udhëton drejt së jashtmes dhe shihet...

*

Është në natyrën e dritës që të mund të mbyllet kështu e megjithatë të mos shuhet gjatë lëvizshmërisë së saj që të qëndroj edhe në errësirë si mendim, ide dhe dije që ta mbaj në mend ndryshueshmërinë e saj dhe të arrijë të vallëzojë, lojën e ndërsjellë Kështu me artin e saj drita mban tubat e materies dhe këndon me krahët spektroskop të dritës himnin e përjetshëm të universit



Nënë

Mos u fol të panjohurve – tha,
tek i shtërngonte dorën një të panjohuri.
Po lindte ime motër.

Më pas, më la aty,
në korridorin e errët të poliklinikës,
në pritje të kontrollit të parë te dentisti,
a thua se po më linte në një kopsht të
gjelbëruar.

Nxitonte për punë, tokësore, eterike
mësuesja ime e anglishtes.

Kaluan vite dhe një herë si rastësisht na
tregoi
që ende në ëndërr fluturonte.

E di, edhe sot, herë pas herë më kontrollo
tek udhëtoj vetëm,
me të panjohur.

Vjeshtë e poetëve

Vjeshtë e poetëve
musht që shkrin damarët e njerëzimit
(merret pa recetë);

jehonë trumpetash në muzg,
mirazh betejash, kthim ushtarësh
shputëdjegur;

e kuqërrëmte ftesë, dëshmi, duel
për këmishën e mëndafshhtë të Pushkinit;

syth premtimi për fëmijë flokëkuq -
shegë - hurmë shartisur në prehër të
nuseve;

shkarpa pëshpërimash, kërcitje në varg,
pikëpresje para dimrit;

një tel kitare ngatërruar në flokët e mjaltë,
ara e korrur shpon si faqe burri.

Në buzët e lagështa të qytetit

Sot është e dielë, bie shi,
në stacion të metrosë artistët e reklamuar
kërkojnë përjetësi,
dhe pëllumbat çukisin dimër.

Vetëm hapat e shpejtë të një gruaje
kumbojnë në platformë,
aty afër një furrë buke premtion,
disa turistë kërkojnë të vendosur një
specialitet autokton,
dhe shpirti im mbështillet me heshtjen e
ishullit
dhe kujtesën e prekjes tënde,
oh, një manushaqe e tharë në xhep
paska udhëtuar pa biletë.

Lulet e egra

Sa herë që dua të shkruaj për kopshtet e
Babilonisë,
për Ishtarin, vezët e ngjyrosura
dhe lepujt *crepuscular*,
për tarracat me portokalle, për ullishtet e
pamosha,
për shpinat e përkulura dhe gishtërinjtë e
ngjyrosur,
me një sens drejtësie, një sens bukurie,
marr një shteg, një shteg që më çon te një
burim,
një burim me ujë të rëndë.

Jam dhjetë vjeç,
kam humbur nënën time të dashur,
humbje e paralajmëruar në një qiell me
lupa resh.

RITUAL DËSHIRE

poezi nga Albana Shala

Albana Shala lindi në Shkodër në vitin 1968. Në vitin 1990 përfundoi studimet për Gjuhë dhe Letërsi Angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Më 1995 studioi për të Drejtën Ndërkombëtare në Institutin e Studimeve Shoqërore (ISS) në Hagë, Holandë, dhe më pas, më 1997, po në këtë institut mori master në Politikë dhe Zhvillim. Në fillim të viteve 90 ka punuar si redaktore në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori" dhe asistente programi në zyrën e Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Tiranë. Në Holandë ka punuar si koordinatore programi me Press Now dhe Free Press Unlimited, organizata që mbështesin mediat epavaruar në zona konfliktuale vendet në zhvillim. Prej vitit 2014, për dy mandate radhazi, u zgjodh në krye të bordit të IPDC (Programit Ndërkombëtar të Zhvillimit të Komunikacionit) të UNESCO-s dhe mbetet anëtare e këtij bordi.

Albana Shala është një nga themelueset e Fondacionit Shqiptar Holandez të Miqësisë dhe anëtare bordi e Fondacionit 'In den Vreemde' i cili mbështet artistët në rrezik. Tregimet e poezitë e saj filluan të botohen në shtypin shqiptar në vitet 90, përkthimet nga gjuha holandeze nga viti 2016. Nga krijimtaria veçojmë:

- | | |
|---|---|
| Në holandisht: | 2010 - Parajsja është e portokalltë, poezie (Dituria) |
| 2009 -De digitale Paus, poezi (Uitgeverij P.) | 2013 - Ngarkesa e fëmijës, tregime (Dituria) |
| Në anglisht: | 2017 - Bisedëme dhjetëmiq (Carabela Books) |
| 2017 - Ten conversations with Albanians (Carabela Books) | Përkthime: |
| Në shqip: | 2016 - Romani "Darka" Herman Koch (Albas) |
| 2008 - Papa dixhital, poezi (Dituria) - i vlerësuar me çmimin Migjeni nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë në 2009 | 2017 - Romani "Virgjëresha holandeze" Marente de Moor (Dituria) |
| | 2020 - Romani "Uria" Jamal Ouariachi (Dituria) |
| | 2022 - Poezi "Vajza e së hënës" (Carabela Books) |

Babilonia, tarracat, ullishtet të gjitha më
largohen
vendin ua lënë luleve të egra, milingonave
dhe bletëve të vonuara.

Gjurmët e sandaleve në baltën e freskët
më thonë që këtë rrugë e bëj shpesh
dhe do të vazhdoj ta bëj,
për aq kohë sa nuk dua të çlirohem
nga lulet e egra.

Uni i vonuar

As si mamaja
kur merr frymë rëndë,
pas një dushi të gjatë;
zëri i saj tingëllon,
më fort se sa dëshiroj.

As si babai, dorë, sy, mosbesim i koduar
as si ime motër, qingj, zemër.

Rini që shëtit në park, pa fatalizëm,
vjeshtë.

Një varkë e mbërritur në port
lidhur me fije të padukshme.

Dielli përvëlon rrasat,

zbardhon udhëtimet,
dhimbja me baticën shkon e vjen.

Pa litarë, pa spirancë,
qetësisht,
përsiatje,
mes erës dhe ujit,

një e çarë për dritën,
një e çarë për ujin.

Dashuria na goditi

Dashuria na goditi,
por nuk na shitoi,
na kqyri, por nuk na marrosi,
na thirri n'emër, por nuk na njehsoi,
pëshpëriti fjalë, por nuk na këndoi.

Na fali një ishull dhe njëqind varka
shpëtimi,
shënoi një vend dhe na dha gurë për një
tempull,
por jo frymë dhe zemër për flijim.

Shënoi sinore, por jo për monopatin
brenda vetes,
na la në duar çelësin e një shtëpie me
mure të lartë,

por asgjë për t'i shembur.

Na ngopi me kënaqësi, por nuk na e
shuajti etjen,
na solli muzat me gjithë mëmën Kujtesë.

Dhe ja ku jemi, shpëtuar marrëzisë,
fëmijë lojçakë, të etur, të arsyeshëm,
dhimbjen e dëshirën bashkë,
të koduara si vaksinë.

Ritual dëshire

Se ç'ka diçka të ngadalte ky ritual
shpalosës
dëshire që si llavë rrëshqet e gjithçka
përpin,
por ka edhe diçka të brishtë si flatër zogu
shtrenguar lehtas në shami.

Një erë e madhe fryn mes dy rrahjesh
zemre,
na merr e na hedh tutje,
atje larg përtej kohës së matshme që
ndajmë.

Prandaj ngulem në shkëmb, këmbëfortë si
molusk,
hap e mbyll kapakët me ritmin e valës
tënde,
në trup mëndafsh dhe perlë,
nga brenda jashtë fryn.

Vizatim

Fëmija vizaton një sy
kur i thonë të pikturojë mamanë
dhe një si enë kur vizaton të atin,
apo ndoshta është një buzëqeshje,
e mbajtur me një shkop.

Të dy i vendos mbi ca si dallgë,
sepse tashmë fëmija ka parë detin.
Janë të mëdhenj, pa masë e perspektivë.
Bota është një vijë e pafundme që pret të
lidhet.

Dashuri Eonike

Kishte një univers para tonit, kishte jetë në
shumë yje, hënëza dhe botë të pafund.
Njerëzit jetonin për mijëra vjet dhe
gjeneronin energji në vazo yjesh.
Kllounët e përkulnin hapësirën dhe kohën
herë pas here, dhe mund t'i zhbënin këto
akte, pa asnjë problem.
Marrja e transportit publik nëpër galaktika
ishite kënaqësi.
Mbaheshin referendume për të përcaktuar
kuptimin e jetës e votuar për Miss
Universin, megjithëse koncepti i plakjes
nuk ekzistonte.
Migrimet vlerësoheshin si ndërmarrje
shumë të nevojshme.
Disa shqetësoheshin për ruajtjen e dritës,
e vetmja monedhë energjie në univers:
drita eonike.

Dhe kishte Dashuri. Lindte nga përkulja
e energjisë dhe shkëmbimi i ngrohtësisë
midis njerëzve eonikë.
Dikush mund të thotë se qëllimi i universit
ishite të sigurohej që drita e dashurisë do të
mbërrinte te ne, në të ardhmen.
Ata flisnin me dashuri për ne. Sepse na
kishin ëndërruar. A thua se na njihnin, na
lexonin, si një libër. Sikur ne të paskëshim
qënë në të kaluarën e tyre dhe ata në të
ardhmen tonë.
Çdo rrahje zemre atje i korrespondonte një
rrahje zemre në universin e ri.
Dhe Shpërthimi i Madh nuk ishte gjë tjetër
veç dhimbjet e lindjes së dritës së universit
përmes vrimave të zeza gëlltisëse.
Ne, fëmijë të një dashurie eonike.





STALKER (ZONA E TARKOVSKIT)

Nga Andrea Tarka

Filmi “Stalker” nis me prezantimin e hapësirave ku jetojmë, të cilat kanë një mungesë drite dhe ngjyrash. Jeta në përditshmërinë tonë thith elementët me të cilët rrethohemi, është një reflektim i tyre. Ndikohemi prej vendeve dhe njerëzve ku kalojmë pjesën më të madhe të ditëve. Që në krye të filmit vihet re mungesa e dritës, ose një ngjyrë e vetme (nëse mund të quhet e tillë), bakër i bërë pis, i cili vesh çdo gjë që të sheh syri. Tërheq vëmendjen “pissllëku”, i cili mbulon gjithçka, si të bëhej fjalë për një vend të “pajetueshëm”, e sërish njeriu vazhdon të jetojë jetën e tij “normale”. Të duket se momentet e gëzueshme janë larguar njëherë e mirë dhe jeta kthehet në diçka të ngjashme me burgun e “Montekristos”, ku njeriu shpreson në dy gjëra: të arratiset ose të vdesë sa më shpejt. Shpresa e Tarkovsky-t shfaqet nëpërmjet të panjohurës, ishuj kujtimesh të fëmijërisë, të cilët rrinë në pritje të Odisesë tashmë të harruar. Stalker, personazhi kryesor, duket se ngjet më shumë me regjisorin dhe në të njëjtën kohë më kompleksi në film. Ai është udhërrëfyese i shpirtit që dëshirojnë të shpëtohen, në rastin tonë të shkrimtarit dhe shkencëtarit. Megjithatë ai duket se e vuan më shumë realitetin dhe ndjen nevojën më shumë se të tjerët për të gjetur shpëtim. Stalker mbetet personazhi më kompleks i filmit, pikërisht sepse nuk mund të analizohet, por vetëm të ndjehet. Brenda tij ndodhet vetë regjisorin, i padeshifrueshëm, si vetë ëndrrat. Mesazhet që jepen janë pa formë, vetëm ndjesi, e megjithatë duket sikur janë më pranë të vërtetës. Andrei Tarkovsky në intervistat e tij shprehet se filmat e tij janë copëza ëndrrash apo kujtime të mbetura nga fëmijëria e tij, të cilat kanë mbetur të pakuptuara plotësisht prej tij. Në filmat e tij,

shfaqet plotësisht, gati-gati lakuriq dhe flet për gjëra, të cilat ashtu si shikuesi përpqet edhe ai vetë t'i kuptoj.

Njerëzit e kërkojnë të vërtetën, por ajo ndryshon pamje duke humbur sërish, ndoshta sepse ajo nuk i përket askujt dhe duke u përpjekur ta bëjnë të tyren, ajo largohet. Besimi në zot na afron më shumë me të vërtetën, njësoj siç ndodh edhe me ëndrrat, dashurinë, artin dhe të gjitha ato gjëra, të cilat duart e “materies” nuk arrin t'i prekin. Në këtë kërkim bën pjesë edhe vetë Tarkovsky, i vënë në kërkim të “Zonës”. Çdo njeri ndjen në momente të caktuara se ndodhet në një vend të paqte, kudo që të ndodhet në tokë buron nga një vend i shpirtit. Aty ndodhet i vetëm, jeta në “realitet” s'mundet ta cik, e pazëshme njësoj siç përshkruhet në film, i paarrtshëm nga valët apo influenca të tjera. Duke qenë se është një “Zonë”, rrethohet nga caqet e realitetit, të cilat e rrezikojnë në çdo kohë atë.

“These are intangibles, where the moment you name them.”

Pra një “arratisje” prej jetës ku jetojmë. Në skenën e parë vihet re kjo gjë. Stalker përpqet të ngrihet nga shtrati, ku fle sëbashku me gruan dhe vajzën e tij të “veçantë” të prekur prej Zonës. Pengesat për të mbërritur tek Zona janë ato gjëra që na lidhin me realitetin. Gruaja e tij e ndjen largimin e tij dhe duke i renditur të gjitha detyrimet që kishte në lidhje me të dhe vajzën e tij, përpqet ta pengoj atë.

Pra njësoj siç u shprehëm për të vërtetën, ai vend brenda nesh duhet të jetë i fshehtë, i pazëshëm, i padukshëm dhe në momentin kur ndryshon, atëherë ajo humbet. Ka një ngjashmëri kjo ikje fshehurazi e tij, me atë që bëjmë ne të gjithë në jetën reale sikur të

kërkonim të largoheshim nga përditshmëria mbytëse për të kërkuar një vend paqeje. Njësoj siç bën Stalker për në zonën e tij. Më bën përshtypje pissllëku që mbulon gjithçka, duke e bërë të pajetueshëm për syrin e pamësuar, e sërish njerëzit jetojnë, jetën “normale” të tyre.

Dy shoqëruesit e tij në kërkimin e tyre të “Zonë-s”, ku njëri është një shkrimtar i mbetur pa frymëzim dhe tjetri një shkencëtar, i cili duket më i vështirë për të kuptuar arsyen përse zgjedh të kërkojë “Zonën”. Mendoj se ata nuk janë aty rastësisht për të shoqëruar Stalker në këtë rrugëtim. Ndoshta Tarkovsky kërkon të na tregoj dy fushat me të cilat ai përpqet të zbulojë të vërtetën dhe sëbashku me Stalker, që për mua personifikon ëndrrën dhe të pandërgjegjshmen, e cila ndodhet brenda çdo njeriu. Shkrimtari është personazhi, i cili mbart veset tek njeriu, Egon e tij, që përpqet të thithë sa më shumë nga lëngu i jetës, derisa thahet në fund dhe sërish i shtyrë nga etja për ta kërkuar diku tjetër atë. Figura e tij është plot kontradikta, ai ka çdo gjë që një njeri do dëshironte, por duket se i mungon esenca për ta plotësuar këtë. Atij i mungon frymëzimi për të krijuar, për të vazhduar të jetë një shkrimtar i suksesshëm.

Shkencëtari është misterioz dhe mosbesues, njëjtë si shkencën kundrejt Dijes dhe të Vërtetës. Në fundin e filmit ai do të përpqet të shkatërroj Zonën me një bombë 20 kiloton. Bile për këtë veprim ai është i bindur se po shpëton njerëzimin prej bombës duke e shkatërruar atë sëbashku me një vend të kotë siç është për të Zona. Këta personazhe janë brenda Tarkovsky-t, po aq janë universal, brenda secilit prej nesh si pengesa të vockla për të qenë ata që jemi.

Me të mbërritur atje, shenja e parë që vunen re se diçka kishte ndryshuar, ishte momenti kur njëri prej tyre thotë: *“The flowers have no scent.”* Çdo gjë që na është mësuar mbi jetën në tokë, tek Zona, ajo bëhet e pavlerë, në mos e kundërta është e vërtetë.

“Hardness and strengths are death's companions, flexibility and softness are the embodiment of life.”

“Your most cherished desire will come true here. Your sincerest wish, the desire that has made you suffers most.”

“There's no need to speak. You must only . . . concentrate and recall all your past life. When a man thinks of the past, he becomes kinder. But the main thing is you must believe. Now go.”

A nuk kemi të gjithë ndonjë dëshirë apo ëndërr në sirtar, të cilën e mbajmë të fshehtë, e duam edhe pse herë-herë na bën të vuajmë? A nuk kemi një “Zone” të gjithë ne, me të cilën i japim jetë dëshirës apo ëndrrës sonë, në momentin e krijimit? Ajo Zona mundet, që për disa të jetë vetë Arti. Sipas Andrei Tarkovsky-t, e kaluara na bën njerëz më të mirë dhe nga ajo mundet të lindë diçka e re dhe e bukur, por për këtë duhet besimi.

“The unselfishness of Art. Now take music. It's connected least of all with reality, or if connected, then it's without ideas. It's merely empty sound without associations. Nevertheless, music miraculously penetrates your very soul. What cord in us respond to its harmony, transforming it into a source of delighted. Uniting and shattering us. Why is all necessary? And above all, for whom? You'll reply: For no reason. No. I doubt that. For everything in the final reckoning has a meaning. A meaning and a reason.”

Për mua Arti është besim, mbi hyjnoren dhe shpirtëroren duke na afruar më shumë me zotin. Ego mungon në Art, sepse krijimi bëhet për shpëtimin e shpirtit tënd dhe se ai duhet t'i dhurohet të tjerëve. Arti është një lutje, pastrim i shpirtit prej helmimeve të së kaluarës dhe ashtu siç shprehet për Artin dhe muzikën, hyjnorja tejshton trup e shpirt duke e dridhur atë nën frekuencën e saj.

Një nga dilemat ekzistenciale na vjen pikërisht nga personazhi, i cili mbart në vete më shumë vese. Ai dyshon më shumë rreth vetes dhe gjërave që e rrethojnë, të gjitha ato që lidhen me egon e njeriut. Shkrimtari na sjell këto fjalë: *“You put your heart and soul into your work, and they devour you. They even devour the filth in your soul. They're all literate. They all have voracious appetites. They all keep crowding round-journalists, editors, critics, a constant stream of women. All they're clamoring for more. What kind of writer am I, if I detest writing? If it's a torture for me, a painful, a shameful occupation, something akin to extruding hemorrhoids. I used to think my books helped some people to become better, but nobody needs me. If I die, in a couple days, they'll find someone else to devour. I wanted to change them, but they're changed me to fit their own image.”*

Të qenit njeri normal, të bërit një jetë normale duket se nuk mjafton. Qytetërimi është si një makinë e madhe grirëse dhe teknologjia është shpejtësia me të cilën ajo na grin shpirtin tonë dhe me të ushqen trupat tanë. A mundet njeriu të vendos tërë energjinë në shërbim të asaj makine grirëse? Unë mendoj se të gjithë do thonim jo, por megjithatë ne vazhdojmë ta bëjmë atë siç kemi bërë shekuj me rradhë. Qytetërimi është një trup gjigand, i cili kërkon të ushqehet, njësoj si në përrallat me Kuçedra, të cilat ruajnë ndonjë thesar dhe për këtë kërkon sakrifkimin e djemve dhe vajzave më të mirë. A mundet njerëzimi ta mashtroj apo ta mund atë, apo të gjithë do të përfundojmë në gojën e tij/saj një ditë?

POEZI- “Now the summer is gone, and might never have been In the sunshine it's warm, but there has to be more.”

It all came to pass, All fell into my hands, like a five-finger leaf, but there has to be more.

Nothing evil was lost, Nothing good was in vain, All blaze with clear light, but there has to be more.

Life gathered me up Safe under it's wing, My luck always held, But there has to be more.

Not a leaf was burned up, Not a twig ever snapped Clean as glass is the day, But there has to be more.”

Profesori i shkencës, i cili ka qëndruar në heshtje përgjatë gjithë rrugëtimit, tregon afër fundit të filmit qëllimin e ardhjes së tij tek Zona. Ai është i vendosur dhe i bindur se shkatërrimi i Zonës është në të mirë të njerëzimit. Kjo “luftë” e tij, ngjet me luftën që prej kaq shekujsh shkencën udhëheq kundrejt besimit, duke e qajtur atë të panevojshme, bile me raste edhe të dëmshme. Nga të tre personazhet, i vetmi që e kundërshton këtë, është Stalker dhe ata që ai përfaqëson. I patundur në besimin e tij tek Zona, ku ai sheh shpresën dhe shpëtimin e tij, duke e shprehur këtë në një nga monologjet e tij.

“There's nothing left to people on earth. This is the only place to come when all hope is gone. You have to come here. Then why destroy hope (zone)? A stalker is forbidden to enter the room. Especially for his own selfish reasons. Remember Porcupine. Yes, I'm a louse. I've never achieved anything and I can't do anything here. I have nothing to give my wife. I can't have any friends, but don't deprive me of what's mine. They took everything from me the barbed wire. Everything I have is here. Here, in the zone. My happiness, my freedom, dignity. They're all here. The people I bring here are

unhappy like me. They've nothing left to hope for. Nobody can help them. But i can- a louse. A louse can help them! I weep for joy because i can help them. I ask for nothing more"

A nuk na ndodh të duam të afrojmë shpirtra, që si ne janë njësoj të palumtur? Tërhiqemi prej tyre pa e kuptuar përsenë, ndoshta sepse mundemi të jemi për ta shpresa që refuzon t'i braktisë. Mundemi të kthehemi në Stalker të njëri-tjetrit edhe sikur të jetë vetëm një shpresë e ëndërrt.

"They're thinking to sell themselves cheap, how to get paid for every breath they take. They know, they were born to be "someone" to be an elite! They say you live, but once. How can such people believe in anything at all? Nobody believes. Not only those two. Nobody. Who shall I take there? Oh, Lord. The most terrible thing . . . is that nobody needs the Room and all my efforts are in vain. I'll never will go there with anyone. Gruaja- If you want, I'll go with you. Do you want that? Do you think I've nothing to ask for? Burri- No, you mustn't. Gruaja- Why? Burri- No. What if you fail, too?"

Skena Stalker me gruan e tij, të bën përshtypje personazhi i tij dhe ndryshimi që pëson, nga njeriu që ishte i gatshëm të bëhej guidë për të ndihmuar të tjerët, të mbërrijnë tek Zona dhe tani si pasojë e pasigurisë që vetë ai ka dhe zhgënjimit të tepërt, shfryn kundrejt shkrimtarit dhe shkencëtarit. Dua t'i lidh personazhet me ato që mund të përfaqësoj për secilin prej nesh. Stalker nga njeriu gjithmonë i butë, i sjellshëm, plot shpresë, i cili dukej se arrinte të shihte qartë gjërat me shpresën se mund të ngjallte besimin brenda tyre. Pra shpirtërorja të mbizotëroj mbi materialen dhe duket sikur edhe përpjekjeve të mira mund t'i vijë fundi një ditë, pa arritur në fitoren finale. Këta njerëz (shkenca, krijuesit) kërkojnë të vlerësohen, të dallohen mbi të tjerët. Njerëz të tillë nuk besojnë në asgjë dhe kjo e dërgon Stalker-in në dëshpërim. Nëse as shkenca apo arti nuk mund të besojnë tek hyjnorja, atëherë kush mund ta bëjë? Në këtë pasiguri të tij, e cila e torturon, ia trondit besimin dhe ashtu si njeriu sadopak nis të kthehet në egoist me frikën se edhe ai mund të sakrifikoj apo humbas. Andrei Tarkovsky mendoj se përpiqet të na tregoj natyrën njerëzore, e cila sado të jetë e lidhur me dijen, besimin, hyjnoren, asnjëherë nuk mundet të shpëtoj nga pasiguri apo frika se mund të humbas gjërat e dashura për të. Të gjithë ne, pa përjashtim, i nënshtrohemi këtij rregulli. Tek Stalker e vëmë re në dialogun me gruan e tij, kur ajo i vetëfrohet për ta ndjekur sëbashku me vajzën për tek Zona dhe befasi ai stepet dhe ia kthen: ti nuk mund të vish, sepse nëse do të dështosh

edhe ti, atëherë çdo të bëhet me mua? Ata kanë një marrëdhënie të veçantë midis tyre, në dukje nuk janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin, por sërisht diçka i pengon të qëndrojnë të ndarë. Në monologun e saj na shfaqet njëkohësisht gruaja universale që të gjithë njohim. Mbështetëse e burrit të saj dhe njëkohësisht shtylla e vërtetë e shtëpisë. Forca e saj është një tjetër, ajo është e qartë për vështirësitë me të cilat përballen dhe përkundrejt të shoqit, i cili gjithnjë shqërohet nga pasiguri e tija, ajo ka fuqinë për t'i përballuar ato. Ndoshta sepse ka një prirje të bashkëjetoj me keqardhjen më të thellë në shpirt, pa e humbur shpresën.

Vajza është personazhi më enigmatik, bota e saj e brendshme tepër e pasur, e cila duket sikur është mbledhur brenda dhe s'mundet të shprehet nga pamundësia e trupit. Në sytë e saj prej fëmije që refuzojnë të qeshin si gjithë fëmijët e tjerë. Ndonjëherë duket sikur njeriu paradoksalisht, sa më pak të mundet të flas më gjuhën e trupit, aq më shumë e bën atë me forcën e syve. Vajza është personazhi i vetëm, që Zonën e ka brenda, ndërsa të gjithë përpiqen të mbërrijnë, në mënyrë aksidentale është e vetmja e prekur prej saj. Për ta bërë sa më të kuptueshme, regjisori e bën nëpërmjet fuqive të saj telepatike.

*POEZI- "How I love your eyes, my friend
With their radiant play of fire
When you lift them fleetingly
And like lightning in the skies
Your gaze sweeps swiftly round.*

*But there is charm more powerful still,
For the moment of a passionate kiss.
When through lowered eyelids glows.
The somber, dull flame of desire . . ."*

Ky film, ashtu si në përgjithësi të gjithë filmat e tij, nuk kërkon të kuptohet sepse ato janë si ëndrra, apo pikëpyetje të mbetura nga fëmijëria. Përpara filmit të gjithë jemi spektator, këtu nuk bën përjashtim as regjisori vetë. Në fund, mundem të them se akoma nuk e kam kuptuar se çfarë do të thotë Tarkovsky me Zonën. Megjithëse kam kuptuar dhe ndjerë në mënyrën time, por ama di që gjendet një Zonë dhe ndoshta do ta kërkojmë atë deri në frymën e fundit pa arritur dot ta gjejmë, apo të mos pranojemi brenda, kur të ndodhemi aty. Mundet, që ajo të na prekë vetë, nëse fati ynë do jetë i njëjtë me atë të vajzës së Stalkerit. Është me rëndësi se çfarë njeriu kërkon në jetë dhe akoma më e rëndësishme ajo që mbetet pas gjurmëve që lemë.

Uroj të kënaqeni ndërsa e shihni, vetëm për kaq pak, do të thotë vërtetë shumë.



Onufri boton kujtimet e fotografit personal të Hitlerit

HITLERI ISHTE MIKU IM

Nga Heinrich Hoffman

Heinrich Hoffmann ishte një nga njerëzit kryesorë që e bëri Hitlerin legjendë, fotografi i cili me kujdes për-punoi imazhin e Fyhrerit si një figurë perëndie. Hoffmann botoi albumin e tij të parë me fotografi në vitin 1919, duke qenë fotograf zyrtar i ushtrisë gjermane. Në 1923 ai u bashkua me partinë naziste, ku dhe filloi lidhja tij me Hitlerin.

Ai u bë fotograf zyrtar i Hitlerit dhe udhëtoi shpesh me të. Bëri mbi dy milionë fotografi të Hitlerit, të cilat u shpërndanë gjerësisht, duke përfshirë dhe si pulla postare, një ndërmarrje që solli shumë fitime për të dy burrat. Hoffmann botoi disa albume mbi Hitlerin në vitet '30, duke përfshirë "Hitleri që nuk e njeh askush". Hoffmann dhe Hitleri ishin miq të ngushtë, dhe ai u soll jo vetëm si i besuari i tij personal – kujtimet e tij përfshijnë detaje të rralla të Fyhrerit – por edhe si mbles – ishte Hoffmann që e prezantoi Eva Braun, asistenten e studios së tij, me Hitlerin.

Në fund të luftës, Hoffmann u arrestua nga ushtria amerikane, e cila ia sekuestroi arkivën e tij fotografike, dhe u burgos nga aleatët.




"FOTOGRAFI I HITLERIT". Sigurisht, do të mjaftonin këto dy fjalë, për të kujtuar ata që interesohen për mua dhe pyesin veten: po cili është ky Heinrich Hoffmann?

Me profesion kam qenë përherë fotograf dhe, si prirje, një adhurues i flaktë i artit, botues revistash arti dhe një përdorues i përkushtuar, megjithëse modest, i lapsit dhe penelut. Rrugën si fotograf e nisa në studion e mirënjohur të tim ati dhe, kur më erdhi radha, tashmë isha një mjeshër i sprovuar. Për shumë vjet, mbretër dhe princër, artistë të mëdhenj, këngëtarë, shkrimtarë, politikanë, burra dhe gra të famshme në çdo fushë të jetës ngrinin para objektivit tim aq sekonda sa më duheshin për të përjetësuar njeriun dhe rastin.

Pikërisht në të tilla veprimtari profesionale u takova për herë të parë me Adolf Hitlerin. Nisi si një detyrë e rastësishme, prej së cilës u rrit një miqësi e thellë dhe e gjatë, miqësi që s'kishte asgjë të përbashkët me politikën prej së cilës dija pak dhe akoma më pak shqetësohesha, apo me egoizmin, sepse në atë kohë unë kisha një pozitë edhe më solide se ai. Kjo miqësi lindi nga përplasja e dy natyrave impulsive dhe, në themel të saj, pjesërisht nga përkushtimi i njëjtë ndaj artit, pjesërisht, mbase, tërheqja e të kundërtave – Hitleri, një armik i duhanit dhe alkoolit, nga njëra anë, dhe Heinrich Hoffmann, ku rafsha mos u vrafsha, një bohem bon viveur, nga ana tjetër.

Pikërisht kjo miqësi më mbajti, përgjatë viteve më të dhunshme, më të trazuar dhe më kaotike të historisë botërore, pranë njeriut që luajti në to një rol kyç. Me Hitlerin, fyhrer dhe kancelar i Rajhut të Tretë, pothuaj s'kisha lidhje; por njeriu Adolf Hitler ishte miku im, që nga takimi ynë i parë deri ditën e vdekjes së tij. Ai iu përgjigj miqësisë sime dhe pata besimin e tij të plotë. Në jetën time figura e tij zë një vend të rëndësishëm.





KOMPOZIM ME TË KUQE DHE BLU nga Piet Mondrian

Dr. Bledar Kurti

Teksa shkruaj, njerëz shumë të qytetëruar po fluturojnë lart mbi kokën time, duke u përpjekur të më vrasin.
George Orwell

Në të gjithë historinë e tij, në çdo hap drejt të ardhmes, njeriu ka bërë luftë. Për ironi, të gjitha luftërat që ka bërë njeriu janë kryer ose në emër të dashurisë ose në emër të progresit, dhe shekulli më progresist e më modern i të gjithë kohërave ishte ai i 20-të, shekulli në të cilin industria dhe teknologjia, shkenca dhe mjekësia, letërsia dhe kultura, arritën kulmin epokal, e bashkë me to u rrit edhe miti i njeriut të qytetëruar, i cili, me nivelin e tij të lartë të qytetarisë, dhe në emër të progresit, bëri atë që dinte të bënte më mirë, të vriste. Ndaj edhe George Orwell shkroi për bombat që flatronin mbi kokën e tij nga aeroplanë të pilotuar nga njerëz shumë të qytetëruar, ndaj edhe shekulli i 20-të njihet si shekulli më gjakatar i mbarë historisë së njerëzimit, në të cilin humbën jetën trefishi i të gjithë viktimave të shkaktuara nga të gjithë luftërat ndër mijëra vjeçarët e njeriut që nga krijimi i tij.

Shekulli më vrastar i epokave nisi të shkruante vendmbërritjen e tij të ferrtë me Luftën e Madhe, 1914-1918. U quajt e madhe pasi kurrë më parë historia nuk kishte dëshmuar një konflikt të

atillë. Për shkak të saj, humbën jetën 16 milionë njerëz, e më pas, po për shkak të saj, gripi që u përhap pas kthimit të ushtarëve në vendet e tyre, i njohur si Gripi Spanjoll i vitit 1918, morri jetën e 50 deri në 100 milionë njerëzve. Gjithashtu, ky shekull shënoi edhe lindjen e sistemeve më djallëzore të kohërave, si nazizmi, fashizmi, dhe komunizmi, të cilat e shtuan edhe më shumë numrin dhjetëra milionësh të viktimave e jetëve të pafajshme njerëzore. Lufta e Madhe, Revolucioni Bolshevik, Holokausti, dhe Lufta e Dytë Botërore, bashkë me shumë luftëra civile brenda disa shteteve e ndryshuan botën përgjithmonë.

Dhe si reagan artistët ndaj atij realiteti të paprecedentë? Cili ishte qëndrimi i tyre ndaj një bote të mbuluar me kufoma? Artistët, duke shërbyer si ndërgjegjja e kombeve krijuan një art të ri. Një art që apelonte për një realitet të ri dhe jetë të re, pa dhunë, pa vrasje, pa masakra por e paqte, e harmonizuar, e balancuar, e paanshme, e kulluar, dhe e bukur. Ndaj edhe artisti holandez Piet Mondrian (1872-1944), krijoi vepra të tilla si *Kompozim Nr. 2. Kompozim me të Kuqe dhe Blu*, 1929, në dukje e thjeshtë dhe minimaliste, por me një mesazh të fortë dhe botëkuptim të thellë që cek vetë identitetin e njeriut.

Në këtë tablo vërehen vetëm dy

ngjyra primare: e kuqja dhe bluja. Ato janë të shpërndara në mënyrë të rregullt por të ekuilibruara me njëra-tjetrën. Në një botë të trazuar artisti promovon ekuilibrin. Në një epokë tmerrri artisti jep mesazhin se harmonia mund të arrihet fare thjeshtë. Edhe konceptet e kundërta siç janë këto dy ngjyra mund të arrijnë të bashkëjetojnë e krijojnë bukuri.

Bluja është ngjyrë e ftohtë. Ajo është koncept i arsyes dhe racionalitetit, por edhe e vdekjes, ndërkohë që e kuqja, një ngjyrë e ngrohtë, përfaqëson pasionin, revolucionin, jetën dhe shtysën njerëzore. Kur këto dy koncepte mund të qëndrojnë thjeshtësisht të harmonizuara mbi tablo, edhe vetë njerëzimi mund të arrijë një paqe dhe harmoni të ngjashme. Vepra është një apel për paqe. Një thirrje për një botë më të mirë. "Ritmi i marrëdhënies midis ngjyrës dhe dimensionit ... lejon që të shfaqet absolutja," shkroi ai në vitin 1917. Ndaj edhe në këtë tablo kemi një harmoni absolute.

Figurat drejtkëndore janë ngjyrë të kuqe, blu, por edhe të bardha. E bardha e konturuar me linja të zeza simbolizon kujtimet e harruara. Mondrian apelon për harmoni e fillim të ri, të ndërtuar mbi disa kujtime të cilat duhen fshirë nga ndërgjegjja kolektive mbarë shoqërore, dhe duke konsideruar kapitullin e trishtë e kataklizmit që bota sapo kishte përjetuar, kujtimet e hidhura që duheshin kapërcyer ishin të shumta.

Mondrian-i ka një seri veprash me kompozime të ndryshme trengjyreshë: të kuqe, blu, dhe të verdhë. Ai besonte se piktura mund të kthehej në një lloj konstruksioni pors arkitektura. Ai i ndërtonte tablotë e tij nga elementët më të thjeshtë, si linjat e drejta dhe ngjyrat e kulluara. Ai kërkonte me ngulm një art kthjelltësie e disipline që të pasqyronte ligjet objektive të gjithësisë. Ai donte të zbulonte realitetet e pandryshueshme prapa formave përherë në ndryshim të pamjes së jashtme subjektive.

Kjo vepër transmeton qartë mesazhin se arti reflekton vizualisht tensionet dhe idetë e epokës. Piet Modrian dhe artistët e fillimit të shekullit të 20-të në tërësi synonin të ndreqnin atë që ata shihnin si një kulturë të sëmurë. Ndaj pjesa më e madhe e veprave të krijuara gjatë kësaj periudhe përmbajnë një peshë të madhe shpirtërore. Ata përpiqeshin të zbulonin dhe promovonin të mirën që gjendej e fshihej brenda së keqes dhe të korruptuarës, ndaj edhe çiftëzimi dramatik i formave dhe imazheve paraqitej në mënyrën e tyre më të thjeshtë, bazike e të kulluar. Ky mision ishte qëllimi i Piet Mondrian në të gjitha veprat e tij.


Në këtë tablo të kompozuar me figura të sheshta gjeometrike, me plane të ndërlidhura horizontalisht dhe vertikalisht, simbolizohet rendi natyror, kështu ajo është një ilustrim i rregullit universal. Përsosmëri në tokë. Një utopi barazie dhe harmonie. Pas një lufte të tmerrshme, e sidomos në një botë të trazuar sërisht, e cila do rezultonte në brenda pak viteve edhe në një luftë tjetër botërore edhe më të tmerrshme se e para, apeli i artistit ishte edhe më domethënës. Dëgjoni kombe, thërret vepra dhe artisti, harmonia njerëzore është atribut bazik, dhe të kundërtat mund të bashkohen dhe të arrijnë një ekuilibër, të bukur, të thjeshtë, brenda një skene, pors një tablo dy apo tre ngjyrash.


Edhe linjat e zeza kanë një mesazh apelues dhe simbolizojnë bashkë-ekzistencën. Linjat vertikale simbolizojnë njerëzimin ndërsa ato horizontale simbolizojnë tokën dhe natyrën. Madje ato janë edhe simbole mashkullore dhe femërore. Të ndërlidhura me kuadrat dhe ngjyrat ato krijojnë një rend suprem dhe gjithëpërfshirës, duke shpalosur përpara shikuesit rendin botëror ku njeriu bashkëjeton me natyrën, dhe botëkuptimet e ndryshme mund të ekzistojnë në harmoni të tërë, duke krijuar një skenë botërore në balancë dhe ekuilibër të plotë.

Kjo na tregon edhe për natyrën e artit dhe artistit, që e tejkalojnë botën e tyre të izoluar duke u përfshirë në arritjen e një rendi të ri harmonik e të rregullt botëror. Për shumë vite, bota dhe njerëzimi ishin përpjekur të vetë-shkatërroheshin: në tokë përmes artillerisë, llogoreve, gazit të mustardës e rrënimit të qyteteve; në ajër me përdorimin e aeroplanëve dhe zepelinëve; në det me nëndetëset dhe anijet luftarake. Ndaj një rend i ri harmonik, me prirje drejt së mirës dhe jo të ligës, ishte misioni i ri i artit dhe artistëve të fillim shekullit të 20-të.

I shtyrë nga ky mision, Modrian-i u përpoq gjatë të gjithë krijimtarisë së tij të krijonte një pikturë e cila mund të shërbente si një planimetri për një lloj të ri arti, dhe një përjetim më të vërtetë të jetës përmes artit. Ndaj edhe veprat e tij kanë përmbajtje tejet shpirtërore, dhe shërbejnë si një burim për ripërtëritje në një kohë kur mbarë bota dukej në një çrregullim total.

Piet Mondrian lindi në Holandë dhe jetoi në Paris për disa vite. Ai u kthye në Holandë pak kohë përpara shpërthimit të Luftës së Parë Botërore në vitin 1914. Atje ai u takua me artistin Theo Van Doesburg dhe nën kontekstin tragjik të luftës, në vitin 1917, ata themeluan së bashku lëvizjen e artit dhe një revistë me titullin *De Stijl* (Stili). Ashtu si ato





të grupit Bauhaus në Gjermani, artistët e lidhur me grupin *De Stijl* ishin të interesuar jo vetëm me pikturën, por me çdo aspekt të kulturës pamore dhe materiale, duke përfshirë arkitekturën, skulpturën, stilizimin e mobilieve dhe artet grafike. Tmerret e luftës prekën çdo aspekt të jetës ndaj edhe artistët tentuan të promovojnë harmoninë dhe ekuilibrin në çdo mjedis: ndërtesa, mjedise të brendshme, hapësira publike, etj.

Mondrian-i u largua nga *De Stijl* në vitin 1925, por e vazhdoi rrugëtimin për ta kulluar e pastruar sistematikisht artin e tij, duke vazhduar në misionin e tij idealist për një formë universale të artit. Ai synonte të thjeshtonte pikturën në thelbin e saj, të shpalosur në kompozime harmonike të linjave vertikale dhe horizontale dhe ngjyrave primare. Mondrian-i tentonte të krijonte një art që mund të shërbente si një gjuhë piktoriale ndërkombëtare. Njerëzimi është një, natyra është një, ndaj nëse kombet do komunikonin me njëri-tjetrin përmes formave të thjeshtuara pamore, përmes një gjuhe piktoriale ndërkombëtare, atëherë do mund të arrihej një harmoni dhe ekuilibër global.

Dhe, ky synim i Mondrian-it duket se është arritur jo vetëm përmes tablove të tij por edhe me gjerë përmes konceptit të cilin ai promovonte, pasi edhe në ditët e sotme kompozimet tre apo më shumë ngjyrëshe të Mondrian-it gjenden në fasadat e ndërtesave në qytetet anembanë botës, përfshirë edhe në Tiranë, Durrës dhe qytete të tjera të Shqipërisë, si edhe në interiore godinash, zyrash dhe banesash të shpërndara nga njëri kontinent në tjetrin. Kjo na shpalos atributin e artit si një gjuhë ndërkombëtare që e lidh njerëzimin më pranë njëri-tjetrit.

Arti i Mondrian-it është tejet abstrakt, pa asnjë lidhje me motivet realiste, megjithatë përmes abstraksionit gjeometrik ai shpalos një harmoni të plotë pamore dhe konceptuale, si edhe një formë të balancuar universale. Tablotë e tij duken të thjeshta, por nuk janë aspak të tilla, pasi ato janë të bazuara mbi esencën absolute. Mondrian-i, sikurse edhe artistët e

tjerë holandezë të grupimit *De Stijl* ishte rritur në familje protestante, dhe me një prejardhje kalviniste ai ishte njeri shumë i disiplinuar dhe i matur, si në jetë ashtu edhe në art, në lidhje me atë çfarë ofronte. “Detyra e artit është të shprehë një vizion të qartë të realitetit,” u shpreh ai, por me këtë nuk i referohej asaj çfarë ai shihte apo realitetit në të cilin gjendej njerëzimi, por sesi duhet të ishte rendi harmonik i botës, pa shkatërrimin që njeriu po i bënte vetes dhe natyrës. Ndaj edhe nuk ka linja diagonale në kompozimet e tij, pasi ato simbolizojnë konfliktet dhe shkatërrimin, dhe në realitetin e tij artistik dhe utopik, konfliktet nuk kishin vend, por duke i lënë hapësirë vetëm ndërlidhjes harmonike e të balancuar të forcës që drejton njeriun dhe forcës që drejton natyrën.

Në shumë tablo të tij, të kuqes dhe blusë i shtohet edhe e verdha. Ajo simbolizon dritën, dhe tablotë e tij nisin e kthehen në histori reale të cilat të shtyjnë të endesh drejt dritës si burimi i përsosur i harmonisë dhe përsosmërisë.

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, Mondrian-i u largua nga Holanda për në Londër e më pas në New York. Në Amerikë ai u tërhoq shumë pas muzikës *Jazz* dhe shumë tablo të tij iu përkushtuan harmonisë muzikore të ritmeve të kësaj muzike. Amerika i ofroi një liri më të madhe krijuese, dhe tablotë e tij morën më shumë dinamikë, por gjithmonë duke ruajtur bukurinë ideale, dhe duke shpalosur konceptin e harmonisë dhe balancës universale.

Mondriani e nisi jetën e tij artistike duke pikturuar mullinjët e erës në Holandë, e më pas kaloi në Kubizëm, Fovizëm dhe Abstraksionizëm, gjithnjë në kërkim të idealeve. Ky udhëtim i tij përmes shtigjeve të ndryshme artistike na ka lënë një trashëgimi të mrekullueshme veprash të cilat shërbejnë si një kujtesë e përhershme mbi misionin e njerëzimit për të kuptuar bukurinë ideale, dhe për të përjetuar harmoninë universale. Sigurisht që kjo ka qenë, është, dhe do mbetet një utopi njerëzore, por gjithsesi nuk ka reshtur kurrë së qeni një dëshirë e përhershme fisnike e artit dhe a artistëve të gjithë epokave.

DY ZËRA NË NJË

poezi nga Enkelejda Kondi

Nga Lodëve ia dëgjoj oshtimën.

Ali Podrimjes

Për një grusht ujë i etur,
Për pak paqe, shpirti munguar.
Kokën e mbështete në tokën e dritës,
Me një buqetë të vogël ndër duar.

Por, tani s'ndihem më vetëm,
Se këtu afër, pranë meje,
Shpirti yt këndon ende këngë,
Nga Lodëve ia dëgjoj oshtimën.

Një vjeshtë pa ty

Një vjeshtë pa ty, sa e trishtuar,
M'u duk një vit, një vit i gjatë.
Në stolin bosh gjethembuluar,
Ka mbetur veçse një degë e thatë.

Një vjeshtë pa ty, kujtimet lagur,
Nga qielli që pikon veç shi litarë.
Në rrathe pellgësh vështroj hutuar,
Përhumbem, kohës ëndërrvarë.

Një vjeshtë pa ty, mall i largët,
Ikje që nuk njeh më kthim.
Lamtumirë gjethesh në kalbje,
Diell që shuhet në perëndim.

Dy zëra në një

Në heshtje, në ngjethje,
Pa frikë, pa zë, pa fjalë,
Rrimë strukur prej mërisë
Dhe prapë presim diçka.

S'më fole, s'të fola,
Lojë fëmijësh.
Unë humba, ti fitove,
S'të dëgjova, s'më dëgjove.

Ndaj humbëm të dy,
Se heshtja s'qe më flori.
Atëherë, kush ndjeu më shumë mall
Nga kjo heshtje-largësi,
Unë apo ti?

Zënë si fëmijë
Në skaje mërie të kotë.

Dashuria ka ftohtë!

Nata

Rrugët bosh,
Vetëm semaforët regëtinjë, japin
shpresë.
Një dritë në fund të rrugës
Më tërheq dhe aty e fiksoj vështrimin.
Natës, dritat brenda ndërtesave
I japin ngjyrë gri.

Vetëm qielli është i paanë dhe i pastër,
I gjithëpushtetshmi i kësaj nate.
Në heshtje i falem, si në një kube kishe,
Dhe heshtja më flet me një gjuhë që
vetëm unë e kuptoj.

Ulem të të shkruaj ty,
Fjalë shpirti që ikin drejt qiellit.

Ti

Ti më flet për një dashuri të re,
Ndërsa numëroj gjethen e fundit,
Shkërmoq në duar kujtimet e vjeshtës.

Ti më flet për trishtimin tënd,
Ndërsa të shoh si për herë të fundit.
Shkëmbehemi edhe në mendime si
ditë-nata.

Kurrë s'u përqaftuam njëkohësisht me
diellin





roman



Askush
nuk do ta dëgjonte një vajzë duke bërtitur



MARTIN
STEYN

GJURMË TË ERRËTA



OMBRA GVG
de la signa-21